

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 173, Mars 2018

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro




GJELOSH LULASHI, ANTI-KOMUNISTI MARTIR I KISHËS KATOLIKE

ME RASTN E 72-VJETORIT TE PUSHKATIMIT

Në 'Parajsen' e shpirtërave të martirëve antikomunistë, besoj se shpirti i Gjelosh Lulashit është sythi apo lulja në çelje e sipër, cicërima fluturuese e zogjve shtegtarë, që lajmërojnë stinën e Pranverës, stinë të cilën toka e vendit tim e ka veshur rrallëherë përgjatë historisë.

Gjelosh Lulashi lindi në fshatin Ndreaj, të krahinës së Shoshit, me 2 shtator 1925 i biri i Mires dhe Lulash Gjeloshit. Ka shumë pak të dhëna, të shkruara, për rininë e tij, por imazhet e fiksuara në kujtesën e bashkëmoshatarëve të tij (tashmë të pakët në numër) i japin atij gjithë huret apolloniane të një malësori dukagjinas përfaqësues i tipologjisë fine të riut të kësaj krahine. Ishte ndër ata pak të rinjë dukagjinas që pati fatin që të fillonte studimet në Kolegjin Saverian Shkodër në vitin 1936. Jak Palushi, vëllai i penelistit të njohur Tefë Palushi shprehet "Me Gjeloshin jam takuar tek Kuvendi I Jezuitëve. Ai aty studionte, kurse unë isha në "shoqërinë e Kryqtarëve", aty jemi takuar dhe njohur bashkë. Gjeloshi ishte një djalë i pashëm, i zgjuar dhe serioz, njeri me temperament të fortë, por edhe i qeshur dhe i ngrohtë".



70 vite jetë për të krijuar kopshtin e dashurisë

Vitet i lënë vendin njëri -tjetrit duke shkruar librin e jetës i cili mbetet dëshmia më e mirë e njeriut. Me datën 24 Mars 2018 në ambientet e Restorant "Tradia" Shoqata Atdhetare Dukagjini organizoi një drekë, me rastin e 70 vjetorit të datlindjes së sekretarit të Shoqatës z. Luigj Shyti. Kjo drekë modeste u organizua në shenjë falenderimi për kontributin e vyer që ka dhënë z. Luigj Shyti për shoqatën dhe trevën e Dukagjinit. Të pranishmit në këtë drekë ishin të Shoqatës, familjarë...



Trajtimi i veteranëve - testi më demokratik i një shoqërie civile

Aspak si mitomani, apokaliptik i historisë në posthistori, por si kulturë dhe qytetari, madje si vlerë dhe standart demokratik, e kam parë dhe do ta shoh gjithë jetën time nderimin dhe vlerësimin ndaj atyre që kontribuan apo dhanë jetën për lirinë e kombit shqiptar në çdo pëllëmbë ...



Luigj Gurakuqi tribun i lirisë, demokracisë dhe i përparimit

Burimi i mrekullueshëm i ujit të kripur në majën e Shalës dhe një relacion i panjohur i Imzot Vincenc Zmajević rreth vitit 1728

Zhvillimi i trurit tek të rinjt dhe pasojat e lëndëve helmuese

Para dhejtëra vitesh është menduar se, truri i të rinjve, është ndërtuar nga ai i të rriturve por, ky mendim, që para pak vitesh, është vërtetuar shkencërisht dhe nuk është më vetëm mendim por, një e vërtetë. Shkencëtarët, para ca vitesh, mendonin se truri e përfundon rritjen e tij, ...

Komedia Hyjnore
Ferri, Kanga III

Luigj Gurakuqi tribun i lirisë, demokracisë dhe i përparimit

*Veç një qëllim i naltë t'ban me durue
e zemrën t'a forcon,
ndër kundërshtime s'vjen kurr' me u ligshTue
mjer' ai që nuk qëndron!*

Luigj Gurakuqi është një ndër personalitetet më të shquara të historisë mijëvjeçare Shqiptare. Ai ishte njohës i përkryer i gjuhës e i letërsisë shqipe, poet, prozator, publicist, mësues, ekonomist, poliglot, politikan dhe burr shteti i shquar. Kontributi i tij nuk ka të krahasuar.

Erdhi në jetë me 19 shkurt 1879 në "gjin" e një familjeje shkodrane me tradita qytetare e patriotike. Në vendlindje kreu arësimin fillor ndërsa shkollën e mesme në Kolegjin e "Shën Mitër Koronës" në Itali me mësues De Radën, për të cilin ruajti deri në fund të jetës një admirim të veçantë. Përfundoi studimet universitare në Napoli (Itali) në vitet 1901-1906 ku debutoi me sukses si poet lirik, lëvruar i prozës së shkurtër e publicist.

Nga viti 1906 u rreshtue në ballë të luftës për çlirim nga vargonjtë shekullor të "Portës së Lartë". Në të gjitha zigzaget e historisë u orientuar drejtë duke mbetur simbol i përkushtimit deri në vetmohim për atdheun e robëruar. Ai ndjente dhimbje e revoltë nga padrejtësitë e klasave sunduese në kurriz të vegjelisë e të shtresave të tjera të pambrojtura të shoqërisë shqiptare. Më 1908 në Kongresin e Manastirit u zgjodh nënkryetar dhe anëtar i komisionit për njësimin e alfabetit shqip me shkronja latine. Në vitin 1909 ishte drejtor i parë i Shkollës së Mesme Normale të Elbasanit ku dha një kontribut të vyer për vënien e arësimit shqiptar mbi baza kombëtare e laike. Më 1911 merr pjesë në kryengritjen e malësorëve të Mbishkodrës dhe, si një nga udhëheqësit kryesor të saj, hartoi së bashku me Ismail Qemalin Memorandumin e Greçës. U ndodh në radhët e para për shpalljen e Pavarësisë të Shqipërisë, me 28 Nëntor 1912 duke qenë bashkëpunëtor më i afërt e besnik i Ismail Qemalit.

Biri i shquar i Shkodrës u emëruar ministër i arësimit në Qeverinë e Përkohëshme të Vlorës. Në Luftën e Parë Botërore, gjatë pushtimit Austro-Hungarez, duke shfrytëzuar postin e drejtorit të përgjithshëm të arësimit dhe koniukturat politike, hapi shumë shkolla shqipe. Në kongresin e Durrësit me 1918 zgjidhet ministër i arësimit dhe anëtar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqës në Paris. Në vitet 1921-1924 deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar dhe një nga udhëheqësit kryesor të opozites demokratike për demokratizimin e jetës së vendit, zhvillimin ekonomik e kulturor dhe mbrojtjen e atdheut nga synimet grabitqare të fuqive imperialiste.

Në qeverinë e Fan Nolit emërohet Ministër i Financave. Ai në çdo situatë karakterizohej nga ndershmëria, korektesa, kompetenca profesionale dhe ndjenja e lartë

e përgjegjësisë për krijimin, forcimin e konsolidimin e shtetit të ri demokratik shqiptar. Pas shtypjes së Revolucionit të Qeshorit shkoi në Itali. Më 2 mars 1925 u vra në Bari prej një mercenari të shitur në shërbim të forcave reaksionare që erdhën në fuqi.

Heroi dhe Mësuesi i popullit luftoj me guxim e trimëri deri sa dha jetën për një Shqipëri të lirë e të pavarur, i cila nëpërmjet reformave progresiste demokratike të zhdukte prapambetjen e madhe dhe të fitonte kohën e humbur gjatë shekujve të robërisë.

QËNDRESA

Me gusht shkon vapa e me djelmi kalojnë gjith' prallat e kohës s're.
Si n' dimën bora dhenë, kryet na zbardhojnë vjetët e kujdeset ne.

Me lule t'ershme e larca m'dukej shtrua bota, sa ish' i ri
N'gaz m'shkonte jeta, e s'm'nepej kurr m'u ankuje,
kurr zemra s'm'ndjellte zi.

Andra t'kandshme m'livrojshin nëpër mend si futra pa ja da.
T'lum si vedin nuk njifshë tjetër kend nuk dijshe kurr me kja.

Por andrrat sot kaluen, prallat djelmore janë zhdukun e kanë tretë.
Ideve t'bukura, shtresave lulzore veç emni u ka mbetë.

Oh jeta përnjimend me rrena e vaj plot qenka n'kët botë l'lashtë!
U shueka tepër shpejt lakmim' i saj, si zjarrmi i bam me kashtë.

Veç një qëllim i naltë t'ban me durue, e zemrën t'a forcon,
ndër kundërshtime s'vjen kurr' me u ligshTue, mjer' ai që nuk qëndron!

Kur Fan S. Noli mori lajmin e kobshem, me zemër të pikëlluar hartoi një poezi për bashkëluftëtarin e tij që bëri kaq shumë për "Nanën Shqipëri".

SYRGJYN-GJALL E SYRGJYN- VDEKUR (Elegji për Luigj Gurakuqin)

Nëno moj, mbaj zi për vëllan,
me tre plumba na i ranë,
na e vran' na e shanë,
na i thanë tradhëtor,

Se të deshte kur s'të deshnin,
se të qante kur të qeshnin,
se të veshte kur të zhveshnin,
nëno moj, të ra dëshmor.

Nëno moj, vajto, merr malin,
larot ta përmbysën djalin
që me Ismail Qemalin
ngriti flamurin trimëror.

Nëno moj, ma qaj në Vlorë
ku të dha liri, kurorë,
shpirt' i bardhë si dëborë
ti s'i dhe as var për horr.

Nëno moj, ç'është përpjekur
gojëmjalt' e zemërhekur,
syrgjyn-gjall' e syrgjyn-vdekur,
ky Vigan Liberator.

NË KUVEND U ÇUE NJË BURRË

Në Kuvend u çue një burrë
që i dha lajmin Shqipërisë:
Që sot me këtë flamur
thymen prangat e robnisë.

Nga të gjithë u ba një be:
Shqipëria asht e jona,
për liri dhe për atdhe
flakë i bajmë zemrat tona.

Ball për ball atje në Krajli
fjala e jote peshoi randë,
ju kërkue vetëm liri
pa zaptue, pa tiranë.

Gurakuq të kemi pranë
në çdo zemër ke një vend,
që kudo anembanë
dritë i jep kombit tend.

SHTEGTOJNË DALLËNDYSHET

Nuk e di zog i shtrenjtë
Që afër mejet fluturon
A do të mundësh me e gjetë
Mërgimtarët kush i dëbon?

Fatkeqit i vdiq gruaja
Duke u ngjitur për litar
Në mes valëve shkoj e shuemja
Atje është varri i saj.

Në thellësitë e territ të natës
Qindra njerëz hypen në vapor
Vajza e vogël kërkon nanën
I fshinë lotët me shami në dorë.

Britma fëmijësh, oh sa siklet!
Nga tmerri nuk kanë gjumë
Në mes tyre një grue thërret:
"Burri im mori fund!"

Tyyy...tyyy... ushton vapori
Është bërë gati me u nisë
Na "pushtoi" kudo mizori!
Vendin tonë me e braktisë!

Jam dallëndyshja ciu, ciu
Ah, zemra ime e shkretë!

Shumë të këqija i vijnë njeriut
Nga lubitë në tokë dhe në det!

Medet, ç'është kjo përplasje?!
Po na futet uji mbrenda!
Na mbyten djajtë me dashje!
O Zot, ç'don këtu tek ne vdekja?!
Mizoria nuk ka limit!
Tmerr i madh kudo në sallë!
Dikush lutet me gjithë shpirt!
Kurse tjetri shpërthen në vaj!

Disa herë e mjera nanë
Dallëndyshet fluturuan mbi det
Ato krahët i përplasen në valë
U bën gati për me "vdekë"!

Nana babe- erdhi dallëndyshja
Ajo qënka shumë e bukur!
Po bir-përgjigjet gjyshja
Është si lule dhe si flutur!

Gjyshe u ban dy dallëndyshe
Duan me ardhë në shtëpi
Kërkojnë një jetë ndryshe
A ti lejoj mbrenda me hy?

Shiko nanë si fluturojnë
Janë krenare me dinjitet
Ato jetën e fitojnë
Me djersë të ballit ditë e netë.

Do të çojë me bagëtitë
Atje lartë në shpat të malit
Të ushqesh e të mjelësh dhitë
Në qytet të sjellësh tamblin.

Kurse ti të shkosh në arë
Çdo punë duhet të bësh
Të jesh kurdoherë i parë
Asgjë mangut mos të lësh.

Të prashitësh e të ujitësh
Këtu tek ne nuk ka orar
Të vjelësh e të kositësh
Dhe pastaj të bësh mullar.

Menjëherë u çuen dallëndyshet
Rreth e rrotull u shpërndan
U tmerruen moj nana babe!
E s'po dijnë në breg me dalë!

Është nata e mergimit
Sherbëtorë në dyer të botës!
Dhe "Poema e Mjerimit"
Në "kerthizë" të Evropës.

Ç'është kjo fotografi?
Nuk mund ta shikoj!
Në dhe të zi Ti me hi?!
E shkreta, kush të denoj?!

"Dallëndyshe" të paska vra
Pjella e ndyrë e "Qytetërimit!"
Çdo shqiptar duhet me të kja
Me shpatë në dorë kundër kimit.

Përgatitur nga **Luigj Temali**

“VDIQE” O MUÇO... TË RROFSHIN BIJTË E BIJAT!

REAGIM SATIRIK, nga Lazer Kodra

Kur morëm vesh të “vdekjen” tënde, o Muço Kristali, edhe gjaku i zemrës na u ngri! Besoje!-Për Zotin “Po”! E si mos të na ngrihet gjaku o Muço Kristali, pasi dhimbja për Ju pllakosi jo vetëm familjen tënde, të afërmit, shokët e shoqet, por edhe një ‘familje’ të madhe ‘studentesh e studentësh’ që pollën nga duart e mendjet e grupit tënd të “artë” përgjatë viteve që mbretëroje si një Aleksandër i Madh, Pirro apo Luigji i XV-të! A të kujtohet o Muço Kristali, plaku i urtë i Antikitetit me emrin Akadem, i cili për të sjell EDENIN në tokë e fali tokën e tij për të ndërtuar një shkollë. Lavdia e tij shkoi aq lart saqë sot tempulli më i lartë i arsimit quhet AKADEMI, vetëm e vetëm falë emrit të tij dhe vetëdijes së lartë se shoqëria emancipon falë arsimimit të njerëzve. Sot, unë nga posti i “lartë” që kam propozoj që për “kontributin tënd të vyer” termi AKADEMI këtu në Shqipërinë tone të ëndërruar të zëvendësohet me termin MUÇODEMI! Të garantoj, se po u miratua propozimi im do të rrëmbesh qindra duartrokkitje. I rrëmben, sepse në vendin tim, injoranca dhe duartrokkitjet flasin shpesh...aq shpesh sa ç’shkojmë në banja! Ti vdiqe o Muço Kristali përpara se të vdisnin “vëllezërit” tuaj si Argenti, Vitrina, e disa të tjerë që mjerisht nuk po ua di emrat, pasi toka jonë ka një “mitër” pjellore të pa parë në këtë fushë të “diturisë së gjerë!”. Vdekja jote është tragjike o Muço Kristali, pasi Ju ishit një “shkencëtar” i vërtetë edhe në fushën gjenetike të antropologjisë njerëzore: I transferove idetë dhe dituritë nga foleza normale e trurit në folezën monetare të kuletës! Bravo të qoftë o miku ynë Muço Kristali! Parajsë e Xhenet pastë shpirti yt fin! Tek Ju u falën ministra e kryemistra. U shkolluan, u diplomuan, mbrojtën tituj shkencorë, madje edhe Doktoratura e çfarë të duash tjetër! “Moralin tënd e humanizmin tënd” nuk e pati askush. As humanistët e vjetër, as Filobilikët, as Bejtexhinjtë, as Rilindasit e Naim Frashërit, as periudha e Pavarsisë e ... e askush tjetër! Tek Ju u falën edhe kryqalinjtë edhe gjysmëhanat më tepër se sa tek

Krishti apo Muhamedi! Sisat tua të plleshme “ushqyen” jo vetëm mendjet “e ndritura” që ka ky vend, por edhe përtej kufinjve atërorë. A të kujtohet o i ndjeri Muço Kristali sherbimi i vyer që i bëre liderit suprem të Lega-Nordit, Umberto Bosi, për nevojën që kishte për të birin!? Ndoshta të kujtohet! Prandaj kontributi yt është kaq “madhështor”, saqë shtrihet që nga i biri i Umberto Bosit deri tek tasi yn i kosit! E “bekuar” qoftë toka që pjellë humanistë të tillë! Por, ti nuk ke vdekur o Muço Kristali! Ti ke lënë një “familje” të madhe prej gjashtëmbëdhjetë mijë pjestarësh, me diplomat tuaja në duar. Kaq diploma do të ishin të mjaftueshme për të ndertuar Amerikën “E shkatërruar”, Gjermaninë “E rrenuar” apo Anglinë “E mjeruar”! Por fati qendron në anën tonë, o Muço Kristali! Këto mendje “të ndritura” i kemi këtu në Shqipërinë tonë të dashur. Këto mendje i kanë dhënë Asaj “Dinjitet, prosperitet, ekuilibër, zhvillim, demokraci e çfarë të duash tjetër!”. Ne, që morëm krahë nga puplat (leshit) i nënsqetullës tënde, sot jemi kudo. Përjetësojmë Ty edhe me ministra në ministri, edhe me deputet në parlament, edhe me kryetar bashkish, edhe në drejtim, edhe në shëndetësi edhe në arsim. Fryma Juaj ndjehet kudo, prandaj edhe ky vend ka ecur “përpara”! Ti je i shkrirë dhe i ngjizur në çdo gjë të këtij vndi, ashtu si besimi Panteist i Naimit për Zotin. Zoti na ruajtë se sa gjatë do të jetojë fytyra, ngjyra, aroma, cicmici, e “humanizmi” yt në këtë vend! Të qofshim borxhlinjë përjetë! Ti, që na ngjite në “Piedestale” do të rrosh përjetë në zemrat tona. Ju ftoj për një minutë “Zi kombëtare!”. I përjetshëm kujtimi i Tij! MINISTRIA, d.v.

SHENIM; Për të ilustruar këtë reagim satirik, sot me datën 7 mars 2018, në ditën e mesuesit, po postoj një fragment nga poezia e At’ Gjergj Fishtës, me titull: NAKFOMONICIPEDIJA.

Kjo është një poezi plot humor e satirë (që thumbonte shqiptarët trutharë e të pakulturuar) me rastin e botimit nga Dom Ndoc Nikaj (Pseudonimi i tij NAKDO MONICI) të librit “Histori e Shqypnisë”. Në këtë poezi, Fishta e lavdëron së tepërmi autorin Nikaj, por duket sikur i

thotë: A e din për kë ke shkruel!?

NAKFOMONICIPEDIJA

Ti me gjasë, Nakdo Monici
S’ din si ecën n’ ketë jetë “cicmici”,
Qysh se ty mund ta haja palla
Se po kape m’ breg me prralla:
Due me thanë, tue vu mbi letra
Se ç’ ka ndodhë ndër kohë të vjetra,
Kinse (gjoja) t’ njohë fara e Shqiptarvet
Si pat kë në besa e të parvet!
Eh! Zotni, t’ ngjatët Zoti jetën!
Pa shikoe `i herë kuletën
E ajo ty ka me t’ kallzue,
Se shka t’ zit ke fitue
Me njat t’ bukrën histori
Qi ke shkruel për Shqypni:
Asë (gjen), idhnm pa fe nevoje,
E ndo borxh edhe shtypshkroje?...
Sod n’ Shqypni, more lum miku;
Histori asht meteliku;
Pse për tjetër për këtë besë,
Veçse i qet ti za vall kresë,
Veçse i lanë ti krye t’ gomarit,
Tu mundue për fis t’ Shqyptarit,
Pas Shqyptarët, si jen` tue pa,
Sod me sod s’ janë tue pas nga (ngë, kohë)
Me u hutue me shkrimet tona
T’ cillat s’ pjellin napoljona,
As nuk bahen besa, shkallë
Për me u njitë ku bahet pallë:
Punë qi lypen sod ndër ne,
Për me u rrekun për atdhe.
Ktu` zotni, t’ ngjatët Zoti jetën!
Për pa e luejt pak gja kuletën,
S’ çilet shteg as bahet rangë (prokopi)
Pse e kanë xanë shqyptarët atë kangë:
“Haja qenit-pija qenit
Edhe bjer Kara dyzenit!...”

Imzot Robert Ashta, ipeshkëvi dioqezës se Pultit, ne përvjetorin e vdekjes

Imzot Robert Ashta, ipeshkëvi i dioqezës se Pultit, ne 20 vjetorin e vdekjes. Ishte e diela e Pashkëve te Ngjalljes, 12 prill 1998, rrethe orës 3 pasdites, kur ndërroj jete. Ipeshkvi i Pultit Robert Ashta. Pasi ka mbaruar meshën e shenjte ne kishën e Shën Gjonit ne fshatin Kisha te Dushmanit ne prani te një numri te madhe besimtarësh te ardhur nga gjithë lugina e Kasketës se Drinit nga Temal-Dushmani, Toplana, Berisha, Qelëza, e deri nga Iballa e Pukës, ku ende popullsia nuk e kishte migruar ne zonat urbane. Ipeshkvi pasi ka dhënë bekimin e banoreve eshte njoftuar se ne fshatin Kllogjen te Dushmanit një i sëmure ka nevojë për sakramene. Udhëtonte kështu ne mushke ne një rrugë te vështire, ku sapo ka hyre ne fshatë jep shpirtë ne fshatin Kllogjen ne Dushman. Udhëtonte kështu mbi mushke, drejte cakut te fundit te jetës se vet. Po ne te njëjtin vende para 390 vjetësh këtu ne Dushman vdes edhe Imzot Pjeter Budi një nder shkrimtaret e pare te gjuhës shqipe. Askush me shume se Imzot Robert Ashta nuk i përngjau paraardhësit te tij për te dërguar fjalën e Krishtit nder malësore. Burrat e Dushmanit duke ju prir kryeplaku Nder Shkoza me nderime te mëdha e përcjellin ipeshkvin e tyre ne vige nga fshati Kllogjen për ne Kisha Arre, pastaj me varke e makine drejte banesës se tij ne Kuvendin e fretërve, ku kishte nisur dhe jetën e formimit te tij.

Imzot Robert Ashta lindi ne Shkodër me 22 gushte 1918. Shkollën fillore e te mesme i kreu pranë kuvendit te Shën Franceskut ne Gjuhadore, Shkodër. Veshi zhgunin e fretërve te vegjël me 13 korrik 1934 ne Troshan, ku kreu dhe vitin e

novaciatit. Pas kushteve te përkohshme, me 24 gusht 1935, vijoj studimet ne Shkodër. Me 23 gushte 1939 beri kushte e përjetshme ne famullin e Thethit. Nga viti 1939 deri me 1944 vijon studime filozofike e teologjike ne Siene e vijon dhe i kreu ne Motta di Levenza Trevizo Itali. Me 1941 mori urdhrin e diakonatit ne Venedik, për tu shuguruar me pas meshtar ne shenjtoen Zoja e Mrekullive te Motto di Leven-ces, Triveso. U kthye menjëherë ne Shqipëri dhe nisi shërbimin meshtarak ne famullit e Dukagjinit e te Mirditës, me 1944-1946 shërbeu ne Curraj te Epërme e ne Baz-Bushkashe te Lurës. Gjate kësaj kohe ishte dhe profesor i matematikes ne Liceun françeskan Ilyricum. U detyrua te ndërpres shërbimin meshtarak ku regjimi komuniste e thirri nga altari për te kryer shërbimin ushtarak. I deshe te rrokte armët qe deri atëherë nuk e kishte prekur kurrë me dore. Pas detyrimit ushtarak u kthe ne Lure ku shërbeu nga 1950 - 1955. Nga ky vite deri ne 1967 shërbeu ne famullin e Vuklit e Selce. Eshte viti qe ne vendin tone u mbylleen te gjitha kishat. Ka jetuar ne familjen e vete duke punuar si punëtor krahu ne komunale e ne vitin 1974- deri me 1985 do te punoj ne veprat e dritës ne Vaut-Dejës e Komanit.

Kame pasur fatin te njihesha për afër pasi ne mbarim te vitit te pare te shkollës se mesme ne 1979 te punoj ne brigadën e ujësjellësit te Benës ku nxënësit e shkollave ndihmoheshin nga shteti për te siguruar pak te ardhura për veshje. Ne ketë brigade punonte baba ime e shume burra te tjerë nga gjithë vendi dhe mua me caktojnë ne brigadën e Baftjar Merit, një shkodoran me kulture e i qete. Detyra ime ishte qe punëtoreve te brigadës ti furnizoja me ujë. Baba im, Kol Zefi si fëmijë qe isha krahas te tjerëve, me këshilloj qe te ose harroj as Cesk Ashtën, ku me shpjegoje se ka kenë priftë. Kështu u njoha me ketë punëtor qe mbante kominoshe e çizme dhe një këmishe te bardhe. Çdo dite bënte dy ore ne këmbë nga zona “A” ne Koman e tek kanali qe po hapej për te sjelle ujin e Benës ne Koman. Jetonte ne një barake dërrasash dhe kishte modifikuar disa pantofla prej dërrase me llastike për te shkuar nga banesa për tek dushet qe ishin te përbashkët për te gjithë punëtoret. Shume dite ngarkohej me detyre për te lexuar shtypin e ditës para fillimit te punës, ku çdo brigat 15 minuta para pune lexonte gazetën “Zëri i Popullit”. Rrinte ne vetmi te plote dhe

fliste tepër rralle. Banesa ku jetonte ishte afër Kishës se Shën Markut ne Koman ku ne atë periudhe ishte kthyer ne një mulli bloje për kooperativen. Dua te cilësoj se edhe pse feja ishte e ndaluar shume njerëz ju drejtoheshin ne fshehtësi për me treguar ditët e festave fetare. Me 1990, kur prifti Dom Simon Jubani Kremtoje meshën e pare pas regjimit komunist At’ Robert Ashta ndodhej pranë altarit te Kapelës për te vazhduar meshën pas çdo te pa pritire qe munde te ndodhte gati për te vijuar kremtimin. Me 18 nëntor 1990 kremton meshën e pare publike ne Bajze, qe nga 10 janari 1992 shërbeu si famullitar ne Laç, duke zgjeruar shërbimin edhe ne Rubik, Baz-Bushkash e Lure. Pikërisht ne ketë stine te vonë te jetës, kur kishte mbushur 75 vjeç, françeskani At Robert Ashta u thirre për detyrën e rëndësishme te Ipeshkvit. Ishte vete Papa Gjon Pali i II qe gjate vizitës se tij ne Shqipëri me 25 prill 1993, e shuguroi ne Katedralen e Shkodrës Ipeshkëvi i Dioqezës se Pultit. E imzot Robert Ashta, ndonëse tashmë perlat vijonte ti ngjitej maleve te thepisua, here ne këmbë e here ne mushke me kryqin e madhe te ipeshkvit i fshehur pak nder palat e zhgunit.

Gjate gjithë kohës ne detyrën e Ipeshkvit beri gjitha përpjekjet qe te ngrihen Kishat ne Dukagjin qe ishin shkatërruar nga regjimi komuniste, me një pune te palodhur, përveç ndërimit te veprave te kultit, punoj për kultivimin e besimit ne masën e malësorëve, ku duhet te përmendim përgatitja e një Liberi për katekizmin dhe botime te tjera te besimit. E pikërisht atje ne shtigjet e vështira te Dushmanit Krishti e thirri nga Pashkët tokësore, ne Pashkët pa mbarim te Mbretërisë Qiellore. Ishte 12 prilli 1998, e diela e Ngjalljes.

Edhe pse kane kaluar 20 vite ende për banoret e maleve te Dukagjinit ruhet ne kujtesë përkushtimi i këtij prelati i cili me çdo kusht beri përpjekje qe kisha te funksionoi edhe ne periferi. Aty ku ne vuajtje te tejskajshme kurrë nuk e humben besimin ne fenë katolike, qe te paret tanë për te ruajtur fenë jetuan ne male, te cilat Perandoria Osmane nuk mundi kurrë ti pushtojte.

Përgati
Zef Nika, Bruksel

Trajtimi i veteranëve - testi më demokratik i një shoqërie civile

Aspak si mitomani, apo si nostalgjik i historisë në posthistori, por si kulturë dhe qytetari, madje si vlerë dhe standart demokratik, e kam parë dhe do ta shoh gjithë jetën time nderimin dhe vlerësimin ndaj atyre që kontribuan apo dhanë jetën për lirinë e kombit shqiptar në çdo pëllëmbë të Shqipërisë Natyrore, gjatë tërë historisë sonë vijuar me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare deri tek Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndryshe qoftë si aleatë dinjitozë të koalicionit progresist botëror, anglo-sovjeto-amerikan gjatë Luftës II Botërore, po ashtu të atij evropatlantik, prej të cilit, falë investimit të SHBA-ës dhe Natos, erdhi çlirimi i Kosovës nga regjimi gjakatar, millosheviçian, më 24 mars 1999. "Nderimi dhe vëmendja ndaj atyre që sakrifkohen gjakun deri edhe jetën për çlirimin nga cilado lloj shtypjeje dhe shfrytëzimi, kundër çdo lloj zgjedhe dhe mallkimi politik, siç ishte edhe ai i shqiptarëve të Kosovës nën robërinë diktatoriale, millosheviçiane, nuk është tjetër, sipas meje, veçse obligimi i përhershëm i cilitdo që, si demokrat i vërtetë, ndershmërisht, e do këtë vend, e do Evropën e Re, do të Ardhmen e lirë të popullit të vet dhe të popujve tjerë. Dhe, në kompleksin e kontributeve që shqiptarët kanë dhënë për liri dhe dinjitet kombëtar, kam vlerësuar dhe do të vlerësoj, krahas kontributit gandist rugovian, kontributin e luftëtarëve të lavdishëm të UÇK-ës, aleatët me fisnikë të SHBA dhe të Perëndimit për shpëtimin e një populli të vogël, si ai kosovar, nga thundra genocidale serbe, sidomos, gjatë viteve 90-të, maskradë që mori fund me Çlirimin e Kosovës. Me vetëdijen e dyshimit metodik, si kodi i komunikimit evropatlantik, se historia dhe posthistoria vazhdojnë të jenë fare pranë njëra-tjetrës, si vëllezërit siamezë, për ata që dehen nga sindroma e entuziazmit postmodern, sidomos për popujt e vegjël si yni, që ende nuk kanë arritur të zgjidhin Çështjen e tyre Kombëtare, injorimi, shpërfillja apo cinizmi vulgar me vlerat dhe kontributet historike vinë si mallkimi më i madh, ndaj vetvetes, në posthistori. Ndërsa po blija pranë një tregu ambulant, në qytetin e Koplikut, afrohet pranë meje një burrë rreth të 60-tave, me shikimin e përqëndruar tek libri monografik, "Bislim Kadri Bajgora" të Asllan Istrefit, ish-ushtar i UÇK-ës, që e mbaja në dorë. Me falni se nuk u njoh, -i drejtohem, por më bëri përshtypje përqëndrimi juaj tek libri. "Ju nuk më njihni, por unë u njoh "profesor" Kadriu", - plotësoi komunikimin tregtari ambulant. Lexoni libra, u pëlqejnë, e pyeta? "Ashtu me raste, -u përgjigj bashkëbiseduesi. Unë e njoh autorin e këtij libri, kemi qenë së bashku në UÇK në pranverën e "99-tës", - vijoi. Me të vërtetë, po e thoni këtë, e pyes?!?" Po, po këmbënguli me qetësi dhe dinjitet, madje me gradën e gjeneralit, por që përballë përndjekjes prej UDB-ës serbe, komunikoj edhe sot vetëm me pseudonimin "komandant Skifteri", si ish-anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-ës në Prishtinë. Komandant shtabi kishim Agim Çekun e Kosovës dhe zv.komandant Dilaver Gox-

hajn nga vendi amë. Kam njohur atje edhe Artan Sali Manin nga Reçi i M. Madhe, lindur në Koplik, efektiv i Brigadës nr. 154, i cili jeton në kushte ekonomike mjaft të vështira, në një apartament, me qera, në Prishtinë, vetë i pesti, pa kurrfarë ndihme ekonomike, vetëm me një pension luftime prej 179 evro. Gjithçka detyrohet ta sigurojë me djersën e ballit, askush nuk do t'ia dijë se ishte njëri ndër luftëtarët e UÇK-ës. Ndërsa Admir Brahimi, një djalë i ri, nip në Koplik i Sipërm, u vra në luftën e Koshares, për çka shqyr, më në fund iu lidh një pension luftime prindërve të tij në Shkodër." Për veten time, -vazhdoi ish-komandant "Skifteri", -pas 27 vitesh shërbimi në ushtrinë shqiptare, edhe pse me Akademi Ushtarake të kryer, u largova vullnetarisht nga ushtria. Nuk kam pranuar pension luftime, sepse nuk shkova atje si mercenarët e sotëm, që shkojnë në vendet tjera, por iu përgjigja Thirrjes së UÇK-ës, kundër diktaturës gjakatare të Millosheviçit, sepse më thirri shpirti, shpirti i Kosovës së lirë. Me këtë ndjenjë dhe përkushtim do të jem gati tanë jeten time, në emën të bashkimit të trojeve shqiptare, por ajo që më shqetëson është fakti se vazhdoj të jem shumë i keqardhur për vël-lavrasjet mes ikonave të UÇK-ës, të cilët po vriten fatkeqësisht nga shqiptarfolësit e UDB-ës serbe"- përfundoi fjalën e tij bashkëbiseduesi. Ndërkohë Ç.SH, me pseudonimin "komandant Skifteri" më tregon një sërë fotosh në celular, me liderë kosovarë të ditëve tona, asokohe, liderët kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si me: Ramush Haradinajn, Agim Cekun etj. etj. sikurse edhe me ish-presidentin Fatmir Sejdiu. "Unë me gruan dhe tre fëmijët të moshës shkollore jetojmë, thjesht, me biznesin tonë, por në Kosovë kam shokë e shoqe, shqiptarë kosovarë, a shqiptarë e shqiptare nga Shqipëria që jetojnë shumë keq, krejt të shpërfillur në fatin e tyre. Me ta komunikoj shpesh, por po vuajnë edhe sot në paqe, prandaj nuk i harroj dot", - vijoi fjalën e tij. "Ju jeni shkrimtar dhe gazetar profesionist, "profesor" Kadriu, ju ndjek me shumë simpati, prandaj dua t'u tregoj njërin nga rastet më të dhimbshme, sepse ndoshta edhe nuk po më besoni plotësisht", - më drejtohet mua me një shikim të thekshëm, drejt në sy. Ndërkohë ndërpret bisedën dhe më ofron receptorin e celularit: "Foli këtij gazetarit", -i thotë-, shokut të vet të luftës, Hasan Began Halitit, bashkëshorti i një vajze tiranase, Valentinës, që, si u njohën në shkollën e mesme "A.Z. Çajupi" në Tiranë, martohen me njëri-tjetrin po aty, Valentina 17 vjeçe, kurse Hasani 26 vjeç, duke përfunduar që të dy, së bashku, në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Jam nga fshati Brojë, komuna "Skenderaj", fshati i Hashim Thaçit", -dëgjohet, nga ana tjetër e receptorit, Hasani. Nuk lamë pëllëmbë të kësaj zone pa e shkelur në luftë, nga Kosharja deri në Drenicë së bashku me Valentinën e cila u plagos në Klogdarmicë në 1999-tën, sikurse unë në 1996-tën, në dorën e djathtë për çka më shtruan në Spitalin Ushtarak në

Tiranë duke mbetur kështu që të dy invalidë, megjithatë askush sot nuk po do me ditë për hallin tonë. Edhe pse ishim në frontin e luftës, unë isha edhe komandant batalioni, me pseudonimin "komandant Kasemi", prej ditës së Çlirimit të Kosovës, 24 marsit 1999 deri në vitin 2001 mbetëm me një asistencë sociale prej 102 evro e 50 cent, prandaj në 2009-tën, së bashku me gruan ishim në krye të një proteste kundër qeverisë "Thaçi" për të na njohur statusin e veteranit të UÇK-ës si dhe të Invalidit të luftës, president ishte Fatmir Sejdiu. Megjithatë as protesta nuk na solli asgjë: as trajtim, as vëmendje, asnjë mbështetje. Vijuam të mbetemi me 170 evro për person nga statusi i veteranit, kurse asnjë perfitim si invalidë. Kam tre fëmijë, që ndjekin shkollën, i madhi per arkitekt në një shkollë norvegjeze, i dyti shkollën e mesme profesionale, kurse i treti atë fillore po në Skenderaj. Gruaja si e sëmure kronike, vuan nga hipocarcemia, në atë gjendje të rëndë aq, sa kur e kap kriza i duhet të qëndrojë, kudo të ndodhet, 3.5-5 orë e shtrirë. Ditën apo natën detyrohem ta dërgoj në spital, në Skenderaj a në Prishtinë. Vetëm gjatë 2017-tës jam detyruar ta dërgoj 3 herë brenda dy muajsh në sallën e remincionit. Shpenzimet për shendetin e saj shkojnë 230 evro në muaj. Asnjë ndihmë në rastet më emergjente: as taksi, as ndihmë mjekësore, as ambulancë. 100 evro na kushton vetëm fatura të cilën mund të na e jap komuna Skenderaj për dy muaj, megjithatë, edhe pse jemi dy invalidë me tre fëmijë të moshë s shkollore, as këtë faturë nuk na e përballon komuna, po nuk ia bëmë me kohë kërkesën për 6 muaj. Të tjerat shpenzime janë: 60 evro për energjinë elektrike, 12.80 evro për ujë dhe pijshëm dhe 5 evro për mjedisin. Ky është fati i veteranit dhe invalidit të UÇK-ës. Qeveria e Kosovës nuk do t'ia dijë asnjërit këtë sakrificë duke na lënë në mëshirën e fatit, apo të ndihmës që dikush, si rasti i Samil Lustakut, në vitin 2009, na jep në këtë gjendje të braktisur, të shpërfillur, të mjeruar. Por mjerimi ynë nuk ka të sosur, vazhdon gjithë indinjim të ligjshëm Hasani: "Këtij mjerimi po i shërben edhe sjellja korruptive e vet kryetarit të shoqatës sonë, i cili pasi ka hedhur në plehra, në Matiqan, kartelat tona ka shënuar veteranë të rremë, kundrejt 3000-5000 evro shpërbllim për një kartë veterani. Pra në injorim të plotë të të drejtave tona të ligjshme. Edhe mediat tona, përjashtuar RTK/21, nuk kanë ngritur zërin ndaj kësaj situatë të pafalshme. Kështu, siç shprehet, më 7 mars 2018, Radio- Sharri, Dragash: "Arti i burrneshës nga Tirana, nuse Drenice, të cilën dashuria për Hasanin e çoi në Drenicë, kurse dashuria për Kosovën e lirë e rrjeshtoi pranë Brigadës 154 të UÇK-ës, në frontin e luftës për Çlirimin e Kosovës", megjithatë, nëse Kosova e lirë, qeveritarët dhe institucionet e saj, mjerisht, po bëjnë veshin shurdh e syrin qorr përballë fatit të mjerë të këtij çifti të dashuruar sa pas njëri-tjetrit, po aq pas lirisë së Kosovës, Valentina nuk harron të pohojë me dhimbje: "Jam bija e dikujt, jam motra

e dikujt, jam nëna e dikujt, por mbi të gjitha i përkas Atdheut". Me këtë gjuhë a-dhetareje dhe artisteje, gjuhë shpirti dhe dinjiteti, ka pozuar fotografinë e saj unike, Valentina Haliti, e veshur gjysmë zonjë e gjysme ushtarake për t'i nderuar të gjitha femrat që kishin guximin të vishnin uniformën e UÇK-ës. Valentina tashmë nuse në Skenderaj, siç kishte ndarë fatin e jetës me drenicarin Hasan Began Haliti, po ashtu do të ndante edhe fatin e vet me luftën për çlirimin e Kosovës. Vërtet Shqipëria sot, e në veçanti Kosova, janë në ditët më të vlerësuar historikisht, koniunkturalisht, falë mbështetjes së jashtëzakonshme të SHBA-ës, si aleat ynë strategjik, por askush nuk mund të jetë garant i përjetshëm i kësaj koniunkte, nëse brenda vetes nuk ndiejmë dhe nuk zhvillojmë përgjegjësit tona si komb, ku kreun e vendit e meritojnë luftëtarët, pjesë e panteonit të lirisë. Të tillë luftëtarë e luftëtare mbështet dhe nderon gjithë njerëzimi, çdo shtet demokratik në botë. Kushtëzimi me dorëheqje, nëse nuk do të miratohej formimi i Ushtrisë së Kosovës më është dukur hapi më dinjitoz në jetën politike të Hashim Thaçit, si Presidenti aktual i Kosovës, ish-Komandanti i UÇK-ës, pas aktit historik të firmosjes përballë hezimit të serbëve, në Rambuje, në pranverën e 1999-tës. Por kurrësi, tek ky politikan progresist, nuk mund ta kuptoj seriozitetin e këtij hapi me indiferencën institucionale ndaj fatit tejet të vështirë të ish-luftëtarëve të UÇK-ës që ai udhëhoqi, si rasti i çiftit Haliti i cili tashmë i takon Panteonit të luftëtarëve për Kosovën e lirë, pa kontributin e të cilëve, pavarësisht kontributit të shkëlqyer të Natos dhe SHBA-ës, Kosova e lirë do të mbetej përsëri një ëndërr e hidhur në memorjen tonë kombëtare. Kush gabon të gjykojë ndryshe, pëshryn nga vetvetja, injoron autoritetin tragjik të historisë së popujve të vegjël si yni, "fatet e të cilëve, -siç shprehej diplomati i urtë, Babai i Pavarësisë dhe Shtetit shqiptar, Ismajl Qemali, - dalin nga dyert e tragjedive të mëdha". Fuqia dhe legjitimiteti i progresit tonë demokratik si komb, nuk mund të jete ndryshe vetëm si respektim dhe maksimalizim i vlerave tona si komb apo si popull, kurse injorimi apo shpërfillja e tyre, sado vonë, s'mund të jetë tjetër vetëm injorim dhe maksimalizimi i shanseve të humbura të së ardhmes tonë. Nuk besoj se ka shtet serioz në botë, që të mos nderojë panteonin e lirisë, pavarësisht se jetojmë posthistorinë, epokën e deheroizmit. Amerikanët, bie fjala, i konsiderojnë, heronj të SHBA-ës, të rënë në luftën e Vietnamit në vitet 70-të të shek. XX. Të përjetosh shpërfilljeje, të tilla, në dekadën e parë të Pavarësisë së Kosovës ndaj ish-luftëtarëve të UÇK-ës, aleate e shkëlqyer e Natos dhe SHBA-ës, në shkatërrimin e njëres prej diktaturave më gjakatare në Evropë, në fund të shek. 20-të, shpërfillje të këtij lloji duke sakrifkuar, krahas gjakut të derdhur, deri ardhmërinë e një jete normale në liri, si njeri apo familje, si rasti i çiftit Haliti, personalisht e konsideroj rendje e verbër pas kulpragmatizmit, kurse ajo më e dhimbshmja, fyerje të dinjitetit tonë si komb, ndryshe shpërfillja si mallkim i vetvetes.

Kadri Ujkaj,
Malësi e Madhe kritik letrare

70 vite jetë për të krijuar kopshtin e dashurisë

Vitet i lënë vendin njëri –tjetrit duke shkruar librin e jetës i cili mbetet dëshmia më e mirë e njeriut.

Me datën 24 Mars 2018 në ambientet e Restorant “Tradia” Shoqata Atdhetare Dukagjini organizoi një drekë, me rastin e 70 vjetorit të datlindjes së sekretarit të Shoqatës z. Luigj Shyti. Kjo drekë modeste u organizua në shenjë falenderimi për kontributin e vyer që ka dhënë z. Luigj Shyti për shoqatën dhe trevën e Dukagjinit. Të pranishmit në këtë drekë antarë të Shoqatës, familjarë dhe miq e dashamir të z. Luigj, që me pjesëmarrjen e tyre shprehen jo vetëm respektin, por dhe falënderimet për jetën dhe kontributin e tij.

Në fjalën e rastit, Kryetari i Shoqatës z. Ndue Sanaj, u ndal: Jemi mbledhur për një rast të veçante, të datëlindjes së Luigj Shytit, të 70 vjetorit të lindjes së tij!

Shumë shokë e shoqe në shoqatën tonë kanë pasur dëshirë të ishin pjesë e jonë në këtë gëzim të Luigjit dhe të tonin, por për arsye të ndryshme nuk mundën të marrin pjesë të gjithë.

Të flas mbi jetën e Luigjit para jush, që jeni rritë me te dhe e njihni shumë më mirë se unë, jetën e punën e tij, sikur nuk shkon.

Megjithatë më lejoni të ndalem pak:

Luigji dje mbushi plotë 70 vjet! Një jetë e mjaftueshme për tu prezantuar dhe paraqite dikush në jetë.

Luigji një jetë të terë në detyrën fisnike të mësuesit, që me qindra nxënës e nxënësë kanë firmën e tij të mbarimit të shkollës, të fshatit Plan, Xhan, Breglumi, Abat, Theth, Ndërlysa, Malin Kolaj, Karmë, Guri i Zi dhe Rragam, të cilët jo vetëm ata apo ato, por dhe pasardhësit e tyre nuk kanë për ta harruar emrin e firmën e Luigjit.

Jo pak prej këtyre viteve në detyrën e Drejtorit të shkollës duke pasur një arritje të veçante nga shkolla në shkollë. Ndosh-ta nuk ju ka takuar të gjithëve për të parendonjë shkollë ku ka qenë në detyrën e drejtorit Luigji. Kam pasur rastin të shoh shkollën 9 vjeçare të Rragamit, në të cilën kishte aq rregull, sa dhe në muret e jashtme të shkollës, nuk shikoje një gërvishitje sa do të vogël dhe këtë punë të tij e kemi publikuar dhe në gazetën tonë, “Dukagjini”. Pra, Luigji ka dhënë një kontribut të veçante në dhënie të dijeve djem e vajzave ku ka punuar dhe në tërësi të Dukagjinit.

Luigji është anëtar i themelimit i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe që në themelimin e saj, kryen detyrën e Sekretarit të Saj, redaktor i gazetës “Dukagjini” dhe që nga viti 2015 është Kryeredaktor i saj. Në këto 15 vite ka dhënë dhe jep një kontribut të veçante në realizimin e misionit të Shoqatës.

Luigji është krijues, me dy vëllime të veçanta poetike, si: “Moj e mira n’ortek të bores” dhe “Lamtumirë mos thuaj”. Luigji është studiues i veçante në fusha të ndryshme, etnografike e historike, dhe që ka kater botime të veçanta, si: “Dukagjini ka vend për të gjithë”, “Gjurmë - syzime etnografike në Dukagjin”, “Dukagjini-rrugëtim në gjenezë” dhe “Duaje emrin tënd”. Nga këto studime, një vend të veçante zë studimi “Dukagjini-rrugëtim

në gjenezë”.

Ne mbyllje, miku Luigj, dhe një here dua te të bej një urim pak ndryshe. Ju sot keni datëlindjen 50 + 20! Këto pranvera, të urojmë t’i gëzosh! Gjithashtu duam te të urojmë të plotësosh edhe 31 pranvera, me plotë shëndet, me plotë mbarësi

të them edhe 100 vite të tjera, se nuk po dua te të fus në pune aq të vështira!

Gëzuar mik!

Gëzuar të gjithë juve miq e mike në këtë 70 vjetor të Luigjit!



e mirësi në jetën tuaj, si dhe deri më sot në shërbim të vetvetës, në shërbim të familjes e të gjithë te afërmeve tuaj, por edhe në shërbim të shoqërisë ashtu siç keni shërbyer dhe deri më sot. Nuk dua te

Pastaj e mori fjalën N/kryetari i Shoqatës, z. Gjergj Leqejza, që në mes të tjerave theksoj: Për këtë punë të veçante në arsim, në punën e realizimit të misionit të Shoqatës, në fushën e krijimtarisë dhe të

studimeve e botimeve, kryesia e Shoqatës, në kuadrin e 70 vjetorit të Lindjes, i jep titullin e nderit “Mirënjohja Martin Camaj”, të një nga albanologët më me zë në jetën e kombit shqiptar, me motivacion “I frymëzuar nga dashuria për Dukagjinin, ka dhënë një kontribut të shquara, në fushën e studimit të etnografisë, të historisë dhe kulturës popullore tradicionale dukagjinase, të cilat pasqyrojnë më së miri zonën e Dukagjinit. Shembull i përkushtimit dhe kontributit të përhershëm në fushën e arsimit dhe në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini””.

Pas fjalës përshëndetësi në shoqërinë e tingujve të këngës dhe urimeve të shoqëruara edhe nga fotot kjo drekë krijoi një atmosferë familjare, e cila jo vetëm sot, por që në krijimet e saj e ka shoqëruar jetën e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Dashuria dhe vlersimi për njëri –tjetrin janë dhë sekretit i suksesit tonë. Si bijë dhe bija të Dukagjinit do ecim kështu së bashku në gëzime dhe vështërsi. Ky është shembulli më i mirë që në për 15 vite po japim.

Duke e falënderua z. Luigji për punën dhe shembullin e mirë i urojmë jetë të gjatë dhe plot suksese. Duke shfletuar fletët e librit të jetës tendë, takojmë një njeri, i cili u lind dhe u rrit në një familje me tradita patriotik, e cila diti të gdhend me mjeshtri virtutet e larta të njeriut intelektual, atdhedashës dhe artdashës. Një familjarë model, patjetër në bashkëpunim me shoqen e tij të jetës, Gjysten, e keni krijuar kopshtin tuaj të dashurisë me plot lule erëkëndshme, të cilat do gëzojnë gjithmonë Pranvera të begatshme. Falënderit z. Luigj e plot zemer po të urojmë – Kjosht jetë gjatë e orë madh!

Përgatiti **Roza Pjetri**



GJELOSH LULASHI, ANTIKOMUNISTI MARTIR I KISHËS KATOLIKE

ME RASTN E 72-VJETORIT TE PUSHKATIMIT

Në 'Parajsen' e shpirtërove të martirëve antikomunistë, besoj se shpirti i Gjelosh Lulashit është sythi apo lulja në çelje e sipër, cicërima fluturuese e zogjve shtegtarë, që lajmërojnë stinën e Pranverës, stinë të cilën toka e vendit tim e ka veshur rrallëherë përgjatë historisë.

Gjelosh Lulashi lindi në fshatin Ndreaj, të krahinës së Shoshit, me 2 shtator 1925 i biri i Mires dhe Lulash Gjeloshit. Ka shumë pak të dhëna, të shkruara, për rrinë e tij, por imazhet e fiksuar në kujtesën e bashkëmoshatarëve të tij (tashmë të pakët në numër) i japin atij gjithë huret apolloniane të një malësori dukagjinës përfaqësues i tipologjisë fine të riut të kësaj krahine. Ishte ndër ata pak të rinjë dukagjinës që pati fatin që të filonte studimet në Kolegjin Saverian Shkodër në vitin 1936. Jak Palushi, vëllai i penelistit të njohur Tefë Palushi shprehet "Me Gjeloshin jam takuar tek Kuvendi I Jezuitëve. Ai aty studionte, kurse unë isha në "shoqërinë e Kryqtarëve", aty jemi takuar dhe njohur bashkë. Gjeloshi ishte një djalë i pashëm, i zgjuar dhe serioz, njeri me temperament të fortë, por edhe i qeshur dhe i ngrohtë"¹. Pas perfundimit të shkollës, në vitin 1942 shpresonte t'i jepej e drejta e studimit në Akademinë Ushtarake të Romës. Situata e turbullt politike nuk e favorizoi një gjë të tillë, ndaj filloi punë si kancelar në spitalin civil Shkoder. Në kohën e okupacionit rreshtohet në anën e "Ballit Kombëtar" i rekrutuar, me dëshirën e tij, nga Kapiten Mark Mala, me të cilin ishte njohur që nga viti 1942 gjatë pushimeve në Theth. Ishte një kundështar i vendosur i udhëheqjes së PKSH. "Në bazë të kësaj miqësie që krijova aty, Mark Mala, kur po ngrihej batalioni i Dodë Nikollit me 1943, më thirri dhe më mbushi mendjen të marr pjesë në të..., me veti kam pasë edhe 13 dukagjinës që u mobilizuan në Shosh. Këta i kisha marrë me konditë që me ndejtë në Shkodër dhe mbasi ikem në Elbasan, 6 prej tyre më dezertuen"². "Gjelosh Lulashit nuk iu ndanë për asnjë çast Marash Pjeter Kulla (Ndreaj), Prekë Ujk Ara (Mekshaj) e Mëhill Kokrri (Palaj)³. Pas nisjes së batalionit për në Elbasan, Gjeloshi, si krahu i djathtë i Major Dodë Nikollit, merr gradën N/toger. Pas Elbasanit, batalioni nis për Vlorë, ku Gjelosh Lulashi me një pjesë të grupit vendoset në Drashovicë. Në konfrontimin e Batalionit që drejtohej nga Dodë Nikolli dhe Brigadës së Parë Sulmuese të komanduar nga Mehmet Shehu pati një rezultat disfatist Major Dodë Nikolli, ç'ka çoi në shpërbërjen e këtij batalioni dhe 'çmendurinë' e Dodë Nikollit"⁴. Pas këtij zhgënjimi të madh dhe konfliktit që kishte shperthyer mes ballistëve dhe partizanëve, Gjeloshi kthehet pran vendlindjes së tij. "Në prag të çlirimit, Komandanti i rrethit të Dukagjinit, Lekë Vojvoda, i beson detyrën e Z/Komandantit të rrethit, detyrë të cilën e kreu deri sa shpertheu konflikti i aramatosur mes forcave nacionaliste dhe UNÇ në qafën e Kolçit"⁵. Në këtë konflikt, Gjeloshi si antikomunist i betuar mban krahu e forcave nacionaliste, ku Komandant i përgjithshëm i Qarkut të Shkodrës ishte Mark Gjon Markaj, i cili i vë në dispozicion 120 xhandarë për t'i shkuar në ndihmë Mark Malës, Gjergj Vatës, Pjetër Mehmetit dhe Mark Tunxhit me shokë, por që nuk arritën të mbërrinin atje për arsye se forcat nacionaliste pësuan disfatë. "Gjithsesi Gjelosh Lulashi, Gjergj Vata, Ndue



Pali dhe pasuesit e tyre, me kokëfortësi, deshën të ndiqnin shembullin e Qafës së Kolçit edhe në Kodër-Shëngjergjit kundër forcave partizane të Brigadës VI e XXVS. Ka qënë nderhyrja e zgjuar e babait të tij, Lulashit, që shmangu një konflikt të pabereqet me pasojat të paparashikuara"⁶. Pas fitores së komunisteve dhe vndosjes së hegemonisë së plote pushtetare, Gjeloshi arratiset në Malet e Shoshit. "Në mal ndejtëm me baben për tre muaj, pastaj vendosëm me u dorëzue dhe i derguem fjalë kushëritit të Kolë Prelës për të ba marrveshje"⁷. Në atë kohë Gjelosh Lulashi, Mark Sadiku, Kolë Ndue, Sadik Marku, Lulash Gjeloshi, Nikë Gjeloshi, Sokol Bala, Mark Vuksani e shumë dukagjinës të tjerë të arratisur në mal ndodheshin në bjeshkët e Pepsujave (Mbasbraniku). Lulash Sokoli i Pepsujave ishte njeriu që me porosi të Profesor Kolë Prelës takohet me Lulash Gjeloshin, Mark Sadikun dhe Kolë Ndue, të cilëve u tha: Vij me porosi të Kolë Prelës. Ai më ka thanë, hajdeni e dorëzoni tek unë, pasi kam hy dorëzuan tek Mehmet Shehu. Ju nuk i keni la duert me gjak e sa për daljen në arrati në mal është një gabim që falet. "Ata kan ardhë me mue dhe pasi kanë hager mjesditë në Pepsujaj (tek shpija e Lulashit), pasdite shkuan në Kodër-Shëngjergjit, u takuan me Kolë Prelën dhe mbasanej kan shkue të lirë në shtëpitë e tyre"⁸. Ky rrefim i Lulash Sokolit të Pepsujave, 45 vjet pas ngjarjes, përputhet tërësisht me deklaratimet e Gjelosh Lulashit në hetuesi ku thuhet: "Erdhëm mbasanej, Prof. Kolë Prela me ndermjetësinë e të cilit shkuam dhe u paraqitem tek Major Ndreko Rino, ku prej andej na derguan të lirë në Shkodër dhe baba me bajraktarin e Shalës shkuan në Tiranë dhe u takuan me Komandantin e Përgjithshëm Enver Hoxha"⁹. Urrejtja ndaj komunizmit ishte e ngulitur në vetëdijen e Gjeloshit. Ajo kishte deputuar deri në palcën e eshtrave të tij, deri në qelizën e fundme të trupit të tij. Ndaj në këto kushte nuk kishte se si të ekzistonte asnjë lloj paqeje shpirtërore midis antikomunistit Gjelosh Lulashi dhe regjimit që shtrinte çdo ditë e më tepër falangat e krimin dhe tetakulat oktapodiane të shperfytytrimit njerëzor. Edhe pse kishte filluar punë pran Spitalit Civil

në Shkoder, mendonte e vepronte pareshtur kundër regjimit. Gjelosh Lulashi, që nga nëntori i vitit 1945 ishte një ndër antarët më të vjetër të organizatës "Bashkimi Demokristian Shqiptar". Qëllimi i kësaj organizate ishte: Përmbysja me çdo kusht i regjimit komunist në Shqipëri. Veprimtaria e kësaj organizate zhvillohej ilegalisht dhe në bashkëpunim të ngushtë me mendjet më të ndritura klerikale të kohës si Danjel Dajani, Pader Xhovani Fausti, Xhakue Mark Çuni dhe me antikomunistët e betuar Qerim Sadiku, Major Gjelosh Luli dhe kushëritin e vet Pjeter Delia. "Pjetër Delinë e kam kushëritin, këtë e mora me vete qysh natën që shkova në mbledhjen e grupit dhe për pakënaqësitë tona kemi pasë bisedue edhe më përpara"¹⁰. E gjithë veprimtaria e kësaj organizate dirigjohet nga mesuesi i ndërgjegjës kombëtar, Pater Gjon Shllaku. Gjelosh Lulashi arrestohet me 13 dhjetor 1945, ndaj të cilit Prokuroria Ushtarake e Rrethit Shkodër përpilon Akt-Akuzen 9/14, Shkodër me 29. 01. 1946 me përmbajtjen si vijon:

1. Ka qënë antar aktiv i organizatës "Bashkimi Shqiptar" ka luajtur rol me rëndësi në propagandë dhe veprime të tjera, sidomos në ushtri.

2. Ka shpërnda trakte në ushtri

3. Ka propozue në mbledhje të ndryshme të organizatës krijimin e dorës së zezë, për të fillue atentatet kundër njerezve të pushtetit.

4. Ka qënë armik i pushtetit popullor, qysh në fillim ka bërë pjesë në formacionet mercenare të krijuara nga oupatorët ku ka pasë gradën N/toger.

5. Veprat e të pandehurit vërtetohen qoftë nga pohimet e të pandehurit si dhe atribumet e të pandehurve të tjerë.

Veprimtaria e tij parashikohet prej nenit 15 të Ligjës mbi Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Ushtarake dhe neni 1 të Ligjës nr. 21, Mbi Sabotatorët e Pushtetit.

PROKURORI I GJYQIT USHTARAK, KAPITEN ARANIT ÇELA.

Ka pasur shumë diskutime nëse kjo organizatë ka ekzistuar në të vertetë apo jo? Po ekzistenca e kësaj organizate është e vërtetuar plotësisht nga dokumentet arkivore dhe deponimet në hetuesi nga Gjelosh Lulashi dhe pjestarët e tjerë të kësaj organizate. E vërteta është se kjo organizatë vepronte në dy fronte; nëpërmes nxitjes së kryengritjeve në terren duke besuar në një zbarkim të mundshëm Anglo-amerikan dhe nga ana tjetër duke tentuar për krijimin e një grupi deputetesh në kuvendin e dalë nga zgjedhjet e vitit 1945. Në luftën politike u përfshi edhe deputeti, Profesor Kolë Prela, i cili mbajti lidhje të ngushta dhe aktive me Pater Gjon Shllakun, Gjelosh Lulashin e Bashkimin Demokristian deri në fundin tragjik të tij. "Gjelosh Lulashi përfundoi në burg, si të gjithë antarët e tjerë të kësaj lëvizje, gjithësesi në mënyrë të paepur kaloi në tortura të rënda për disa muaj rresht. Seanca e XVII-të e Gjykatës Ushtarake Shkodër, e çelur në orën 9. 00 të datës 22. 2. 1946 shqyrtoi vendimin përfundimtar kundër elementëve udhëheqës të organizatës fashiste "Bashkimi Shqiptar"¹¹. Në orën 11. 00, kryetari i Gjykatës Ushtarake, Toger Mustafa Iliazi vuri në dukje 'fajësinë' dhe mbështetur mbi nenet përkatëse ndeshkimit e tyre.

"ME VDEKJE: Pader Xhovani Fausti, Pader Danjelo Dajani, Pader Gjon Shllaku, Gjelosh Lulashi, Mark Çuni, Qerim

Sadiku, Gjergj Bici, Frano Mirakaj.

ME BURG TË PËRJETSHËM:

Gjelosh Luli, Pjeter Berisha, Ndoc Vata, Gjon Shllaku, Preng Zezaj e Zef Mirdita.

ME 30 VITE BURG: Gjovalin Zezaj, Mark Lulashi, Mark Shllaku, Nino Kurti, Andero Petroviç dhe Pjeter Delija.

ME 20 VITE BURG: Luigj Shoshi e Paulin Pali"¹².

Pas këtij vendimi u bë edhe njoftimi i Tiranës zyrtare, nga e cila pritej miratimi përfundimtar i këtij vendimi. Përgjigjia për Gjykatën e Shkodrës mbërriti me shkresën nr. 65, dt. 26. 2. 1946. I vetmi ndryshim ishte se ndeshkimi me vdekje i Gjergj Bicit kalon në burgim të përjetshëm. Ky vendim ishte i firmosur nga vetë Enver Hoxha në cilësinë e Ministrit të luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare. Jo vetem në hetuesi, por edhe në momentin e komunikimit të denimit me vdekje, Gjelosh Lulashi qendroi si i ka hije një idealisti me karakter të pathyeshëm, që përballë ideve e vendosmërisë së tij është gati t'i bëjë sfidë edhe jetës, ndonëse vetëm në moshën 21-vjeçare. Kjo dëshmohej edhe nga Proces-verbali i mbajtur mbi vullnetin e fundit: "Sot, me datën 4 mars, ditë e Hënë, ora 5 mbasadreke, unë aspirant Tonin Miloti, me cilësinë e z/prokurorit të Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, shkova në vendin ku do të ekzekutoheshin të denuarit me vdekje për të marrë fjalën e fundit të tyre dhe për t'u ndodhur prezent në kohën e pushkatimit, të cilët pasi u pyeten para se të ekzekutoheshin thanë...

GJELOSH LULASHI: "Thoni babës të më falin se e kam trazue. Të më falin shokët se ndonjë fjalë e kam thanë prej zorit që kam pasë. Nanës të fala dhe të mi puthin vllaznit. Borxhet që kam mbetë të mi paguejnë prindët. I fali me zemër të gjithë ata që më kan ba keq. Rrnoftë Shqipnia!" Gjelosh Lulashi u ekzekutua bashkë me shokët e tij me 4 mars 1946. U ekzekutua në mënyrën më barbare të mundshme. U ekzekutua afër varrezave të Rrmajve, aty ku preheshin në qetësinë e Amshueshme qindra e mijra shpirta njerëzorë të qytetit të Shkodrës. Ndonëse shumë afër shpirtëve e eshtrave të tyre, trupi i Tij nuk u varros kurrë brenda atyre mureve të bekuara me Vajin meshtar e të Pagëzuar me Vargun Biblik: SHPIRTI U PUSHOFTË NË PAQE! U varros në rëren e Zallit të Kirit bashkë me shokët e tij. U varros pa ledhatimin e ballit të ftohtë nga dora e së ëmës. U varros pa uratën e të atit; Të pastë Krishti në Parajsë! Varri i Tij dhe i shokëve të tij nuk dihet. Ai ishte diku në një cep të zi të tokës Shqiptare. Të kësaj Shqipërie, që historia e udhëheqësit e saj perbetoheshin në të, ndërsa në të vertetë bënë masakrat më të tmerrshme që ka njohur globi. Në emër të saj, turpsisht, lanë qindra e qindra bij e bija pa varre. Kjo tokë e nëpëkëmbur meriton të quhet: "Toka e njerëzve pa varre!" Gjelosh Lulashi mbetet simboli i padiskutueshëm i idealistit antikomunist, i qendrestarit të paepur, i besimtarit në Zot e Krisht dhe një ndër më të merituarit e të qënimit MARTIR I KISHËS KATOLIKE!

Referencat:

- 1-Jak Palushi, gazeta "Dukagjini", nr. 12, Gusht 2005
- 2-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 52
- 3-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 4-AMB, Dosja 1068, fleta 53
- 5-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 53
- 6-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 7-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 54
- 8-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 321
- 9-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 54
- 10-AMB, Dosja nr. 1068, fleta 55
- 11-Prelë Milani, libri "Shoshi", faqe 323
- 12-Gazeta "Koha e re", 26. 02. 1946

Përgatitur nga LAZER KODRA

Befasuese: Shkolla e parë në Gjuhën Shqipe u hapë në Shkodër me 1258, katër shekuj para Formulës së Pagëzimit

By NacionalAlbania on July 10, 2017

Dëshmitë e pafundme të shkollave jezuite-françeskane në Shkodër

Po sjellë në mesin e mijrave studentë që u arsimuen në shkollat klerikale katolike në Shkodër dy pika ujë në atë oaz gjigande:

Faik Konica: "...Me këto e të tjera Kolegji Saverian mbahet në një shkallë të lartë dhe të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e të Europës mund të dëshmojnë se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë, të vihet në një me to ..."

– Prof. Sami Repishti,

Për të argumentuar këtë fakt jam i bindur që do të mjaftojë një dëshmi e Prof. Sami Repishtit, ish nxënës i kësaj shkolle, dhënë në teatrin "Migjeni" pas viteve '90, në një takim me intelektualët e qytetit, tek i cili kam qënë i pranishëm:

"...Kur mbërrita në Francë, kërkuam të dinin arsimimin tim. Iu tregova dëftesën e Kolegjit Saverian, që ata e njihnin dhe për të cilin më thanë se ishte i vlerësuar njësoj me Liceu Klasik francez..."

Bahet fjalë për Shkollat e para në 1258, në Gjuhën Shqipe në veri të Shqipërisë nga klerikët katolikë

"Françeskanët albanezë dhe ata italianë, që njihnin gjuhën tonë, hapën shkollat në gjuhën albaneze pranë kishave dhe kuvendeve, duke filluar me:

– shkollën në Ulqin (1258) dhe në vazhdim

- në Durrës (1278), dy shkolla
- në Shkodër (1345 dhe 1395),
- Tivar (1349),
- Pult (1367),
- Drisht (1396), duke vazhduar
- në shekujt XV-XVIII me shkolla të tjera në Shkodër, Lezhë,
- Stubël (1584), Trafandinë, Kunavi, Dibër, Prizren, Shkup, Elbasan, Ohër etj.

Këto të dhëna dëshmojnë se në ato shekuj të shkuar, kisha katolike albaneze me françeskanët në vijën e parë, i zhvillonin të gjitha ritet fetare në gjuhën albaneze, andaj populli i frekuentonte kishat e kuvendet me dëshirë, duke marrë pjesë aktive në meshat, pagëzimet, katekizmat, kresmat, në celebrimin e martesave etj. Jo vetëm kaq, por françeskanët kontribuan dhe në hapjen e shkollave në gjuhën albaneze. " Sipas shkrimit: "URDHËRI FRANÇESKANË SHQIPËRI"-4, Nga Prof Dr Lutfi ALIA

– 1416 shkolla në Shkodër.

"Shkolla të tilla p.sh. ka pasur disa në Shkodër në vitin 1416: " la scuola overo frataglia de Santa Barbara; la scuola overo frataglia de San Mercurio; la scuola overo frataglia de Santa Croce.(shkolla e vllaznve të "Shen Barbara"; shkolla e vllaznve të "Shen Merkurit"; shkolla e vllaznve " Kryqi i Shenjtë" – e përshtati nga italishtja në shqip – Bep Martin Pjetri). Sipas "KLERIKET SHQIPTARE TE MESJETES" NGA DR. ETLVA LALA

– Në vjetin 1584 u themelue Shkolla shqiptare nga klerikë katolikë në Stubllë (afër Gjilanit- fshat i Malësisë së Karadakut) i

njohun si Kolegji i Shën Lukës në Kosovë.

– Në vitin 1632 – Hapja e shkollës shqiptare të Kurbinit nga Imzot Gjon Kolesi.

– Në vitin 1638 – Etërit Françeskanë



hapën një shkollë në Shkodër dhe në Pllanë.

– Në vitin 1639 – Fretërit e Troshanit hapën shkolla në Blinisht dhe në Zadrimë. Krijimi i këtyre shkollave në gjysmën e parë të 600-ës rrjedh nga një interes i ndjeshëm për zhvillimin e arsimit. Arqipeshkvi Pjetër Mazreku nga Prizreni në raportet e tij (të shkruem në vitet 1632-1633) (thekson) rolin e shkollës dhe nevojën e shkollimit të shqiptarëve.

– 1698 – Padër Filip Shkodra çelë shkollë në familjen Kamsi, në Shkodër.

– Në vitin 1885 në Prizren, gjejmë një shkollë fillore shqipe për vajza.

– 1858 – Kushë Micja çelë shkollën për vajza shkodrane.

– Në vj. 1861 françeskanët çilin ma të parën shkollë fillestare publike në Shkodër.

– 10.1 874 – Çelet shkolla e Parë LAIKE e Kohës së Rilindjes, ku mësohet Gjuha Shqipe e Arithmetike e Shirokës, nga Dom Zef Ashta.

Në- vj. 1879 Motrat Stigmatine çilin ma të parën shkollë fillore për varza e, ma të parën shkollë punët. Aty u rritën me kujdes jo vetëm zonja shtëpijash; por edhe nana shqiptare.

Këto shkolla mund të thuhet, se poqën mendimin me themelue një shkollë publike femnore.

– Në vj. 1879 Motrat Stigmatine çilin ma të parën shkollë fillore për varza e, ma të parën shkollë punët.

Aty u rritën me kujdes jo vetëm zonja shtëpijash; por edhe nana shqiptare.

Duhët pasë përparasyshë edhe, se, që: – në vj. 1882, françeskanët kanë pasë çilë një kolegji për me rritë e me mësue ata që dëshronin m' u ba fretën. Mësimet ishin të rregullueme mbas programit të gjimnazëve t'Austrisë e në vj. 1905, shkolla u ba krejt në gjuhë shqipe.

– Në vj. 1885 ase aty pranë, në Prizrend, gjejmë një shkollë fillore shqipe për vajza.

– N' at kohë dihet e themelue edhe ajo e Shkupit.

– Në vj. 1890-1903 Motrat Stigma-

tine shkojnë në Durrës, e aty mbajnë për 13 vjet një shkollë fillore për vajza e një shkollë për punëdore.

– Në vj. 1893 P. Joakin Serreqi O. F. M.

ndreqë në Selcë një shkollë me lokal për 50 nxënës.

– Në vjetin 1893 – Po këte vjetë edhe P. Basil Chiaroni, O. F. M. çilë një shkollë shqipe në Hot Traboinë.

– Në 1896 (?) në Kallmet Motrat e Mëshirës, kishin shkollë fillore për vajza e djelmë.

– Në vj. 1902 zgjidhët Drejtor i kësaj shkolle P. Gjergj Fishta O. F. M., i cili patjetër vuni pors i gjuhë

mësimi ndër të gjitha landët gjuhën shqipe.

– Në vj. 1897 P. Pjeter Gjadri O. F. M. u ep mësim fëmijve në kuvend të Troshanit.

– Në vj. 1898 D. Ndoc Mjedja çilë një shkollë në Pëdhanë,

– Në 1898 hapët një shkollë në kuvend të fretënve të katundit Rrubikut.

– Në vj. 1901 edhe Biza ka shkollën e vet, ku mëson P. Severin Lushaj O. F. M.

– Në 1904 me P. T. Bicaj O.F.M.

– Në vj. 1907, Shiroka ka shkollën e vet për varza.

– Në vj. 1907 P. Shtjefën K. Gjeçov O. F. M. çilë shkollën në Gomsiqe.

– Në vj. 1907 P. Gentil Biella O. F. M. mban n' Iballe një shkollë në gjuhë shqipe.

– Në 1908, Shkodra merr pjesë në Kongresin e Monastirit ku dërgohen: At Gjergj Fishta, Gurakuqi, Dom Ndre Mjedja, Mati Logoreci, Hilë Mosi.

Krijohet klubi "Gjuha Shqipe" në Shkodër.

– Në vj. 1909 P. Engjëll Vjeshta O. F. M. fëmijët e Bazit i mëson me këndue e me shkruie.

– Prej vj. 1916-1929 katolikët kanë pasë shkolla, të thuesh, ndër shumë katunde të Shqipërisë së Veriut. Mësojshin priftën, fretën e civila katolikë. U ndihmonin pjesërisht prej mbretnisë Austro-Hungare e ma vonë edhe prej Shtetit Shqiptar.

Në ketë periudhë veç famullitarët françeskanë, kanë

– pasë 17 shkolla katundit. Malësorët e largtë s' mujshin me pasë shkolla, por edhe ata kishin të drejtë me kërkue zhvillim. Me

ndihmë të Mbretnisë Austro-Hungareze kje mendue me u çilë një konvikt i madh për djelmë të malëve. Kjo u – realizue në 1907 e, u kje lanë Vëllazënve (Schulbruder), që i çonin fëmijët në Shkollën françeskane. Shumë ndër oficerat, mësuesit e nëpunësit me fis prej malësh, do t'i kujtojnë me andje ata vjetë, që kaluen n' atë konvikt të rregulluem në çdo pikëpamje.

– Në vj. 1924 në vend të klasave plotore e qytetëse kje ngritë prej Motrave Stigmatine normalja.

– Në vj. 1925 çilin një shkollë në Dajç, për djelmë e për varza; kështu edhe – në 1927, në Nënshat.

Në vj. 1930 çilët një shkollë për vajza në Tiranë.

Prej këtyne vërejtyeve të shpejta mund të shihët se gjatë pushtimit otoman d.m.th deri në 1911,

katolikët kanë hapë ndër kohë të ndryshme 47 shkolla shqipe, ndër ta 10 shkolla për varza.

Në vitin 1933 meurdhëntë Ahmet Zogutu mbyllën 74% e shkollave fetare katolike dhe në 1945 e mbylli plotsishtë diktatura komuniste me përkrahjen e projektit absurdë të Jaltës 4-11 shkurt 1945 të anglo-amerikane-sovjetike.

Faik Konica e ka vlersue me këto fjalë nivelin e shkollave fetare katolike: "Me këto e të tjera, Kolegji Saverian mbahet në një shkallë të lartë dhe të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e të Europës mund të dëshmojnë se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë, të vihet në një me to". Sot ajo çmohët ma fort prej nderimit e lirisë, qi i epet seksit femnuer, në kontrast me robni e poshtnim të pagajve e të popujve të paqytetnuem. Edhe në këte pikë katolikët kanë parapri.

Qyshë në fillim të shek. XIX e deri sa s' kje çilë shkolla e Stigmatinëve, vemë re një të nxitun e një zellë për me ngritë shkolla femnore. Varzat mblidheshin nëpër shtëpi private e aty u mësohej me këndue e me shkruie si edhe punëdore. Këta vlejnjë mjaft sa me i diftue rracës shqiptare, se këto shkolla primitive ishin një hap heroik kah kultura.

Kontribute të shënueme dhanë përfaqësuesit klerikë katolikë si At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjedja, At Justin Rrota në Kongresin e Manastirit dhe në Komisinë letrare të Shkodrës. DON NDOC Nikaj, Justin Rrota, Karl Gurakuqi, Mati Logoreci, Kolë Kamsi ishin gjuhëtarë. Ashtu si edhe vlerat e gjuhës saj, gegnishtes, që i japin dore gjuhësisë krahasuese për me u shndërrue në një disiplinë të parë për me hulumtue thellë në prehistorinë e popujve. Por edhe me vlerat e të sotmes saj të mohueme padrejtësisht përmes politizimit të Standardit Gjuhësor të atij Kongresi antishkencor të 1972-shit...../

*Përgatiti për botim
Prof, dr. Zef Gjeta*

Burimi i mrekullueshëm i ujit të kripur në majën e Shalës dhe një relacion i panjohur i Imzot Vinçenc Zmajević rreth vitit 1728

Nga Genc Pecnikaj

Treqind vjet më parë, rreth vitit 1728, një profesor i njohur italian i asaj kohe, kishte dyshimet e veta dhe donte të qartësohej rreth një lajmi, për një dukuri gjeologjike, mbi majën e një mali në Alpet e Shqipërisë.

Profesori ishte Antonio Vallisneri (1661-1730), mjek, shkencëtar dhe fizikant, i përkushtuar në studimin e shkencave të natyrës. Ishte Drejtues i Katedrës së Mjekësisë Teorike në Universitetin e Padovas.

Gjatë karrierës së gjatë shkencore, një nga fushat e tij kërkimore ishte dhe gjeo – hidrologjia; konkretisht ajo e origjinës së burimeve (fontanave) të ujërave, përmbledhur këto në botime të veçanta. Në Leksionet[1] e tij prof. Vallisneri kishte shtjelluar tezën se origjina e të gjitha burimeve të ujërave ishte shiu, bora dhe akulli i shkrirë mbi male, ku pasi bien dhe përthithen nga terreni, shpërthejnë si burime mëposhtë, në kuota më të ulëta sesa majat e maleve.

Por një lajm i ardhur nga një grek i ditur, binte ndesh me argumentet e tij. Ai merrte shembullin faktik të “.....një burimi të kripur, që rrjedh (sipas tij) mbi majën më të lartë të malit të famshëm të Shalës” që shtrihet në krahinën e Pultit në veri të Shqipërisë.

Profesori i shkruajti menjëherë një ish-nxënësi të tij, mjek i njohur në Zara të Dalmacisë (sot Kroaci), ku ju lut që të merrte informacion mbi këtë fakt. Mjeku i Zarës Giacomo Danielli ja plotësoi kërkesën ish-profesorit dhe i siguroi një relacion shumë të vlefshëm, të marrë nga një njeri i besueshëm siç ishte Kryeipeshkvi i Zarës Imzot Vinçenc Zmajević. Kryeipeshkvi i sjell rastin e vet, si dëshmitar okular në rininë e tij i këtij “burimi të jashtëzakonshëm” (cit. V. Z.) mbi malin e Shalës. Në moshën 31 vjeç, në vitin 1701 ishte emëruar nga Papa Klementi XI (Papa Albani) si Kryeipeshkëv i Tivarit (ku mblodhi dhe Kuvëndin e Arbënit më 1703) dhe Vizitor Apostolik për krahinat e Shqipërisë e mëtej. Duke qënë i ri dhe i nxitur nga kurioziteti, ai e kishte vizituar vetë të famshmin burim të kripur.

Relacioni i besueshëm i Kryeipeshkvit Imzot Vinçenc Zmajević e bindi profesorin dhe ja qartësoi dyshimet mbi lartësinë në të cilën ndodhet burimi, që nuk ndodhet në majë “...., por pothuajse në nivelin më lartë të malit”(sipas kryeipeshkvit). Mëpas profesori parashtron kushtet e nevojshme që të lindë fenomeni i burimit: “Mjafton që lart të ketë një shtresë toke me pyje ose shkurre, apo shkarje gurësh me guva e shpella ku të depërtojë uji i shiut dhe bora e shkrirë deri në shtresën e minierës së kripës, duke e larë dhe shpërbërë atë, dhe ti nxjerrë jashtë në sipërfaqe të malit gjithë ato grimca kripe....” (shih përkthimin).

* * *

Historia e mësipërme është një përmbledhje e shkurtër e një dokumenti të vjetër vëzhgimi shkencor dhe historik të botuar fillimisht në vitin 1730 në revistën “Raccolta d’Opuscoli scientifici, e filologici”, Venezia 1730, vol.III, f.215-222 [“Përmbledhje

e punimeve shkencore dhe filologjike”].

Ky tekst, i panjohur deri më sot nga literatura dhe bibliografia shqipe, mban titullin: “Fonte di acqua salata, supposto nella cima altissima del monte detto Sciala” [“Burimi i ujit të kripur, i supozuar mbi majën më të lartë të malit të quajtur Shalë”]. Botimi i dytë këtij shkrimi ju bë tre vjet më pas, më 1733, në volumin e



(Fig.1) Kopertina e revistës “Raccolta d’Opuscoli...” dhe pjesa e dokumentit të botuar (hermes i past, 1730)

tretë[1] të përmbledhjes postume të veprave të profesor Vallisnerit.

Shkrimi është përmbledhur nga një anonim, mbi bazën e shënimeve të ndryshme, të dorëshkrimeve të pabotuara të profesor Antonio Vallisnerit. Anonimi që ka përmbledhur shkrimin është sipas të gjitha gjasave, vetë bashkëpunëtori i profesorit në drejtimin dhe përpilimin e revistës “Raccolta d’Opuscoli scientifici, e filologici” ku u botua ky shkrim, z. Angelo Calogera (1696-1766), shkrimtar, klerik dhe erudit italian, me origjinë nga Korfu. Bashkë me profesor Vallisnerin, në vitin 1728 ideuan dhe nisën botimin e revistës së mësipërme “Raccolta d’Opuscoli...” e cila vazhdoi të botohej deri në vitin 1787, gjithsej 42 volume. Ishte ndër kolanat më me ndikim në shekullin e XVIII-të, në fushën e shkencave dhe filologjisë.

Në këtë dokument bie në sy vlerësimi sipëror që i bëhet këtij burimi të ujit të kripur, si: ...Fonte miracolosa, ...prodigiosa, ...famosa, ...mirabile..., ndërsa për cilësinë e kripës që nxirret thuhet se ishte “...perfettissimo e candido...” [perfekte dhe e bardhë].

Në sintaksën origjinale fjalitë shpesh janë të gjata, me disa nivele nënrenditëse. Kjo më ka sjellë dhe vështirësi në përkthimin nga origjinali italisht duke u përpjekur që të harmonizoj ruajtjen e natyrës “dokument” të shkrimit me rrjedhshmërinë e kthimit në shqip, pa rënduar tekstin. Më poshtë po sjell përkthimin e plotë të tij në shqip[2].

Përkthimi shqip Novellara, 1728

Burimi i ujit të kripur, i supozuar mbi majën më të lartë të malit të quajtur Shalë [Antonio Vallisneri, anonim, Imzot Vinçenc Zmajević] (ekstrakt nga revista “Raccolta d’Opuscoli scientifici, e filologici”, Venezia 1730, vol.III, f.215-222)

Në mesin e argumenteve bindëse që bien ndesh me gjykimin e Kavalier ANTONIO VALLISNERIT rreth origjinës së burimeve, është dhe një që ndonjëherë ato burojnë mbi majat më të larta të maleve. Pavarësisht se Autori ynë[3] ju ka përgjigjur këtyre çështjeve tek Leksionet e tij Akademike[4] numër 30 dhe gjetkë: megjithatë erdhi gjetja nga terreni, bërë nga një erudit grek[5]dimrin e kaluar, duke sjellë saktësisht shembullin e një burimi të kripur[6], që rrjedh (sipas tij) mbi majën më të lartë të

malit të famshëm të Shalës (Sciala) që shtrihet në brendësi të perandorisë turke.

Autori ynë, duke patur rastin e letërkëmbimit me ish-nxënësin e tij, tashmë mjek i njohur në Zara, z. Xhakomo Danielli (Giacomo Danielli), ju lut që ta informojë mbi këtë fakt. Ai ja plotësoi kërkesën, dhe i dha informacione të sakta që i mori nga fort i dituri Imzot Vinçenc Zmajević, Kryeipeshkvi aktual i Zarës, përfshirë në një relacion të besueshëm për Autorin tonë, ku brendia e tij ka shumë kuriozitete të tjera gjeografike dhe njohuri historike:

[Ietra (relacion) e Kryeipeshkvit të Zarës Imzot Vinçenc Zmajević]

Zotëri i shquar, etj.

Pulti është ipeshkvi në Shqipëri në var-tësi të Kishës Primate të Tivarit, i përbërë vetëm nga fshatra të vogla [katunde], të gjitha në male dhe lugina, në një distancë një ditë larg nga Shkodra dhe më pak se dy nga deti Adriatik. Të shtijnë frikën ato lartësi, dhe kjo duket se ka ndikuar tek banorët në natyrën e sjelljeve të tyre të ashpra.

Malet kryesisht nuk kanë shtigje të shkelura, ose shumë pak, që me rrezikun e gremisjes kalojnë në lugina shumë të thella, të cilat formojnë shtrate të vegjël lumenjsh. Disa nga këto male janë aq afër sa që bëhen biseda familjare nga njëri shpat në tjetrin, por për të kaluar nga ky tek ai duhet plot një ditë rrugë e mundimshme dhe e rrezikshme për ata që nuk janë vendas, nëpër rrugë që s’kanë asgjë tjetër veç emrit.

Në majë të një mali është katundi Mollë, nga ku kalohet për në majën e një tjetër mali, nëpërmjet një ure druri jo më e gjatë se tetë hapa, mbi një hendek prej gjysmë milje.

Populli i gjithi katolik roman, kanë zgjedhur ato male të hatashme si bastione të fuqishme kundër fuqisë osmane, që dhe pse është përpjekur shpesh, kurrë nuk ka mundur ti pushtojë ato gryka, e as ti nënshtrojë ata njerëz të pamposhtur dhe të zotët.

Jetojnë në brendësi të Perandorisë Turke, por të pavarur nga turqit; dhe pse është një varfëri e pakrahasueshme kjo besohet nga ata si pasuri e pashembullt, sepse ndryshe nga çdo popull tjetër që i është nënshtuar Turqisë, ata kanë ditur të vetmit që ta ruajnë lirinë si kapitalin më të çmuar.

Në këtë dioqezë janë tre male, më të lartat e këtij rajoni, Bishkazi (Biscavo), Agri (Agari), e Shala (Sciala). Kjo e fundit i tejkalon të gjitha në lartësi dhe kufizohet me Serbinë. Nga lartësia e tij buron një ujë i kripur, që pasi rrjedh disa hapa, humbet. Banorët e çmojnë shumë këtë burim për të bërë kripë të përsosur dhe të bardhë, duke e vendosur atë në basene të bëra me mjeshtëri nga natyra, nga masivet e gurëve përreth, ekspozuar në diell.

Jo larg nga mali i Shalës, mali Emo[7] [lat.Haemus] ose Catena Mundi e Ptolomeut, zbret nga Serbia, kalon nëpër Bullgari dhe përfundon në Detin e Zi; bashkohet me male të tjera, por të gjitha këto në krahasim me lartësinë e dukshme të Emo-s janë më të vogla. Në një largësi prej disa ditësh ndodhen malet Karpate (Carpazi) që ndajnë Shqipërinë nga Maqedonia[8]. Po

njësoj dhe malet e Pultit janë si vargëzime mes maleve më të ulëta, dhe të gjitha bashkë vijojnë duke formuar Kurorën e [Alpeve të] Shqipërisë, duke e ndarë atë nga Serbia dhe Maqedonia. Megjithatë mbi të gjitha dominon mali i Shalës, i mrekullueshëm për shkak të burimit të tij të kripur, që nuk buron poshtë në shpate, por pothuajse në nivelin më lartë të malit.

Banorët e duan shumë këtë burim çudibërës, për të siguruar kripë, përndryshe ata njerëz të varfër nuk mund ta kenë, dhe këtë e marrin si shpërblim për qëndrueshmërinë e tyre ndaj besimit të krishterë.

Në fakt, turqit janë përpjekur shpesh që tu privojnë atyre furnizimin me kripë [nga tregu], gjë që mungesa e saj do të sillte sëmundje të rënda dhe vdekshmëri tek njerëzit, si dhe te blegtoria që janë dhe pasuria e tyre kryesore, dhe ti detyrojnë këta banorë që të migrojnë në rajone më të rehatshme e më pak të ashpra [për ti dominuar]. Megjithatë ata kanë mbetur të zhgënjyer, falë mirësisë së këtij burimi të jashtëzakonshëm, madje këto raste e kanë bërë më të zellshme nevojën për ta kthyer ujin në kripë, dhe për të shpëtuar shëndetin e tyre nga rreziqet.

Shënime të Kavalier Vallisnerit:

Kur duhet të sigurohemi dhe besojmë në relacione të caktuara të njerëzve, gjithashtu edhe atyre të ditur, dhe të angazhuar për tu mbështetur në sistemin e tyre, paraprakisht mund të bëjmë dhe hulumtime historike lehtësisht të njohura. Greku i ditur donte [të thoshte] që Burimi i kripur ishte mbi majën më të lartë të malit; por relacioni i besueshëm [nga kryeipeshkvi] thotë: pothuajse në nivelin më të lartë të malit.

Oh kjo “pothuajse”, kur bëhet fjalë për lartësitë e maleve do të thotë shumë! Sepse kush don të ngjitet mëpas që nga burimi i kripur për në majë të malit, do lodhet e dërsijë nga kjo rrugë e paparashikueshme dhe rraskapitëse, dhe do të kërkojë të pushojë shpesh, siç më ka ndodhur dhe mua disa herë ku, në dukje je një sy larg nga maja e maleve, por që nuk e parashikon dot kurrë mbërritjen atje.

Mjafton që lart të ketë një shtresë toke me pyje ose shkurre, apo shkarje gurësh me guva e shpella ku të depërtojë uji i shiut dhe bora e shkrirë deri në shtresën e minierës së kripës, duke e larë dhe shpërbërë atë, dhe ti nxjerrë jashtë në sipërfaqe të malit gjithë ato grimca kripe, që mbushin porët e tij, të cilat janë vërtet të mjaftueshme për të siguruar nevojat e këtyre malësorëve, besnikë të Selisë së Shenjtë Romane.

[Post Scriptum]

Autori ynë, duke kërkuar dhe njëherë nëse: – mbi malin e Shalës (Sciala, që të tjerët e quajnë Sala [Shala]) ka pyje e livadhe të vetmuara veshur me shkurre, apo vetëm gurë të thyer e të gërryer, me të çara e guva, për të mbajtur dhe thithur ujin e shiut, borën dhe akullin e shkrirë, që shkojnë duke ushqyer gradualisht të quajturin burimi i kripur; – për këtë atij ju kishte përgjigjur i lartpërmenduri, fort i dituri Kryeipeshkëv Imzot Vinçenc Zmajević. Ai vetë, duke qënë i ri 31 vjeç[9] kur u ngarkua me

detyrën e Vizitorit Apostolik për të vizituar mbretëritë dhe provincat e Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë, u nxit nga kurioziteti për të parë të famshmin burimin e kripur.

Për udhëtimin e lodhshëm thotë se ju rekomandua të bëhet me këmbë e me duar, duke qënë se ishte rrugë shumë e pjerrët dhe e thyer, derisa erdhi te burimi që ta shijonte ujin dhe për tu rifreskuar.

Admiri vaskat, krijuan nga natyra për të përgaditur depozitat e ujit, si një kri-pore natyrore, punuar me një përkujdesje hyjnore. Kaloi një tjetër lodhje mbi burim derisa shkeli majën më të lartë të malit, ku gjeti një grumbull gurësh të ndryshëm e të çrregullt, pa pemë, pa bimësi, pa dhe; në mesin e të cilëve bie ujë nga qielli dhe futet bora e akulli i shkrirë, depërton në thellësi të malit, për të kaluar, ushqyer dhe formuar të përmendur burim të admirueshëm.

Po ju qasemi shkurtimisht dhe disa çështjeve që dalin pas leximit të këtij dokumenti.

Risia kryesore që sjell ky tekst i vjetër është letra (e panjohur nga literatura shqipe) e Kryepeshkvit Imzot Vinçenc Zmajević rreth vitit 1728, si relacion i vogël përshkruar mbi krahinën e Pultit dhe faktimi nga ana e tij i ekzistencës së një burimi të kripur në malin e Shalës, nga ku nxirrej kripë “perfekte dhe e bardhë”, siç citon ai vetë. Gjithashtu dhe fakti i një burimi të ujit të kripur mbi majën e një mali, i kthyer në një kri-pore të mirëfilltë, është një risi që vlen të përmendet.

Vendodhja e sotme e malit me emërtimin e vjetër si “mali i Shalës” nga ku buronte uji i kripur.

Toponimi “mali i Shalës” në dokumentin e vjetër, sot në termat gjeografike mund të përputhet me njërin nga dy majat e maleve që ndajnë kufirin mes krahinës së Nikaj-Merturit dhe Shalës së Dukagjinit (dikur të dyja këto krahina ishin pjesë integrale e krahinës së Pultit, ose dioqezës me të njëjtin emër): maja e Ershellit ose maja e Kakisë, jo larg njëra tjetrës.

Varianti i parë: **Maja e Ershellit** (2067 metra). Maja e Ershellit ndodhet mes krahinës së Nikaj-Merturit dhe fshatit Shalë të Dukagjinit. Përbëhet nga dy maja kryesore, të njohura në toponiminë vendore si: maja e Shalës (apo maja e Shalës së Ndërmanjës), e shtrirë nga ana veriperëndimore, që përbën dhe masivin kryesor dhe më të lartë të këtij mali; dhe maja tjetër më e vogël, nga ana juglindore, ose siç quhet maja e Gurit të Fushës së Madhe. Ka marrë këtë emër pasi poshtë shpateve të saj ndodhet një fushë e madhe në një gropë si krater.

Poshtë në shpatet jugore të Ershellit, nga ana e krahinës së Nikaj-Merturit ndodhet jo larg një fshat me emrin Salcë, i cili në përshkrimet e udhëtarëve dhe misionarëve të hershëm, dhe në harta të vjetra, dokumentohet me emërtimin Salsa [ose Salza, ndonjëherë]. Toponimi i vjetër i fshatit “Salsa” është homonimi e pastër gjuhësore me emërtimin italisht të “salsa” tek “Fonte salsa” [“Burimi i kripur”], si në dokumentin që po trajtojmë. Përputhja e emërtimeve mund të jetë fare e rastësishme, por po e parashtrijmë thjesht si hipotezë për një lidhje të mundshme mes emërtimit të vendbanimit Salsa (sot Salca) dhe burimit të kripur (fonte salsa). Në livadhet madhështore dhe në rudinat e bjeshkëve mbi këtë fshat, poshtë majës së Ershellit, ka gjurmë rrënojash dhe përgje gurësh, të cilat sipas gojëdhënave të vjetra kanë qënë vendbanime të hershme të populluara.

Gjithashtu po të “spekulojmë” pak me

emërtimin e vetë malit “Ershellit” (ose siç thirret ndryshe “Arshellit”) ajo përbëhet nga “Er (Ar) + shellit”, ku “shellit” në gjuhën popullore d.m.th. “i kripur, ujë i kripur”.

Të dy shëmbujt e mësipërm toponimikë mbeten vetëm hipoteza, derisa të flasin studiuesit përkatës rreth tyre. Por citimi shërben dhe si nxitje dhe premisë për tu marrë me këto raste të pastuduara.

Maja e Ershellit (2067m) është më e lartë se dy të tjerat që përmenden në dokument, ajo e Bishkazit (Biscavo) dhe e Agrit (Agari). Maja e Bishkazit është rreth 1950 metra, ndërsa maja e Agrit është një majë rreth 1380 metra, si maja më e lartë e një vargu kreshtash ngjitur me Qafën e Agrit (1300metra), nga ku kalon një shteg malor që lidh fshatin Salcë dhe Brisë (Nikaj-Mertur) me fshatrat e Shalës dhe Shoshit (Dukagjin).

Rruga që përshkruan nëpër malet e Pultit Kryepeshkvi Imzot Vinçenc Zmajević, në fakt është rruga e vjetër historike që lidhte Shkodrën me malësitë e thella të Pultit, ku një shteg kalonte nga Shoshi (citohet në dokument katundi Mollë, si dhe ura e vogël ekzistuese mbi humnerën e dy shpateve anësore të lumit) nëpër lugina e shpateve malesh, në Qafë të Agrit (jo larg Ershellit) dhe zbriste në zonën e Nikaj-Merturit. Kjo rrugë malore shtigjesh këmbësore ka qënë shumë e shkelur deri në vitet '50 të shekullit të XX-të. Segmente të caktuara të saj mes fshatrave ku kalojnë, banorët dhe sot vazhdojnë ti kenë si rrugë të të vetme lidhëse.[10]

Varianti i dytë: **Maja e Kakisë (2360m)**. Dhe maja e Kakisë është e vendosur në mes Shalës së Dukagjinit dhe krahinës së Nikaj-Merturit. Maja e Kakisë është më në veri të majës së Ershellit. Nga ana e Dukagjinit kjo njihet dhe si maja e Shalës, ose shpatet e saj si faqja e Shalës. Shpatet e Kakisë në fakt kanë formacione shkëmbore gjeologjike të tilla siç përshkruan në premisa prof. Vallisneri. Ka lugje si vaska natyrore, shkarje masivesh, shpella të mëdha, guva, cirçe e të çara të thella shkëmbinjsh.

Lartësia e majës së Kakisë është 2360 metra, më e madhe se të gjitha të tjerat që jepen në dokument, ajo e Bishkazit, Agrit, si dhe e Ershellit që shqyrtoam.

Pra, për nga lartësia dhe pozicioni gjeografik, maja e Kakisë përputhet më shumë se maja e Ershellit, me thënjën e Kryepeshkvit Imzot Vinçenc Zmajević kur përshkruan majën ku ndodhet burimi i kripur: “...Kjo e fundit i tejkalon të gjitha në lartësi dhe kufizohet me Serbinë”(shih përkthimin). Citimi i fundit ka kuptimin e kufirit ndër-dioqezial mes Ipeshkvisë së Pultit dhe Kryepeshkvisë së Shkupit e cila vinte deri aty, dhe që kishte në juridiksion kishtar dhe popujt e dioqezave të Serbisë.

Gjurmë nga ndonjë gojëdhënë apo histori tek banorët e këtyre zonave mbi faktin e këtij burimi kripe

Nga humlumtime të ndryshme tek banorët të moshuar të atyre zonave, është i panjohur tek ata ky fakt i ekzistencës së dikurshme të një burimi uji të kripur. Mundet që burimi të jetë tharë në shekullin e 18-të, por kjo nuk përbën një kohë shumë të largët, që të ketë sjellë dhe humbjen nga kujtesa popullore të këtij burimi të çmuar kripe, pasi malsorët e atyre anëve janë të shquar në trashëgiminë që u lënë brezave, të historive të moçme,

të rrëfenjave, gojëdhënave, e të ndodhmeve të tyre.

Por dhe nga ballafaqimi me botimet e njohura të relacioneve, letrave dhe korespondenca e Imzot Vinçenc Zmajević, nuk evidentohet fakti i këtij burimi uji të kripur.

Duke ju referuar relacioneve të vitit 1702-1703 mbi Shqipërinë, të Imzot Vinçenc Zmajević, botuar nga albanologu gjerman Peter Bartl në serinë “Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert; – Band II: Notitie uniwersali dello stato di Albania, e dell’operato da Monsig.r Vincenzo Zmajeuich Arcivescouo di Antiuari Visitatore Apostolico dell’Albania” (Peter Bartl, München, 1979), nxjerrë nga kopja që ndodhet në Arkivin e Propoganda Fide (APF) në Vatikan; në përshkrimin mbi gjëndjen e dioqezës së Pultit në fq. 50 citojmë: – “... Le sue stradi non hanno altro, che il solo nome, e dovunque si volge l’occhio, da ogni parte trova oggetti d’orrore, senz’altro di buono, via dell’acque abbondanti, e di perfetta qualita.” [“Rrugët e saj nuk kanë asgjë tjetër veç emrit, dhe ngado që të hedhësh sytë, në çdo anë sheh veç tmerr [mizerje], por ka dhe të mira, për shkak të ujërave të bollshme dhe me cilësi të përsosur”. Pra ka një vlerësim të përgjithshëm për cilësinë e ujërave, por burimi i kripur nuk citohet. Por siç shihet, ka një ngjashmëri të madhe në citim nga ky relacion i vitit 1702-1703, me letrën-relacion të rreth vitit 1728 të dokumentit tonë, në përshkrimin që i bën rrugëve, shtigjeve dhe gjëndjes së vëndit. Gjithashtu dhe nga korespondencat apo letrat e Imzot Vinçenc Zmajević që njohim, të përgaditura po nga studiuesi



Peter Bartl dhe botuar në serinë “Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert; – Band I: Aus dem Briefwechsel des Erzbischofs Vinzenz Zmajević” (Peter Bartl, Wiesbaden, 1975), nuk përfshihet kjo letër-relacion apo ndonjë informacion mbi burimin e kripur.

Rezistenca ndaj pushtimit turk dhe sigurimi i kripës brenda krahinës së Pultit

Ekzistenca e prodhimit dhe sigurimit të kripës në vend brenda krahinës së Pultit, të një kripe të cilësisë së lartë siç dëshmon Kryepeshkvi Imzot Vinçenc Zmajević, mund të jetë dhe një arsye tjetër jo e vogël se përse këta malësorë rezistuan dhe nuk u nënshtuan nga turku, pasi kripa është një nga elementët e domosdoshëm të zinxhirit ushqimor. Përsa jepet nga të dhënat në dokument, turqit ndoshta nuk e dinin ekzistencën e këtij burimi ku nxirrej kripë, por

kjo nuk është shumë e besueshme.

Shpjeguesi:

1 “Lezione Accademica intorno l’Origine delle Fontane” – Antonio Vallisneri, bot.I-rë Venecia 1714; bot.II-të Venecia 1726 [“Leksione Akademike mbi Origjinën e Burimeve”].

2 “Opere fisico-mediche stampate e manoscritte del Cavalier Antonio Vallisneri...”, vol.3, Venecia, 1733 [“Punimet fiziko-mjekësore, të shtypura dhe dorëshkrim, të Cavalier Antonio Vallisnerit...”]

3 Falendëroj Doktorin e Shkencave (PhD) z.Illir Pecnikaj (laureuar në Universitetin e Milanos), për korrektimin e vlefshëm të materialit të përkthyer

4 Autori ynë – shkruesi (anonim) nënkupton prof. Antonio Vallisnerin

5 Libri “Lezione Accademica intorno l’origine delle fontane” (Antonio Vallisneri; bot.I-rë Venecia 1714; bot.II-të Venecia 1726) (Leksione akademike mbi origjinën e burimeve [fontanave])

6 Një erudit grek (...un eruditissimo Greco) – nuk dihet se kush është ky grek, por nga të dhëna indirekte, nisur nga korespondenca e prof.Vallisnerit, mund të jetë njëfarë Giorgio Condilli [ndoshta arbëresh] nga ishulli Paros i Greqisë.

7 Termi “burimi i kripur” në tekstin origjinal është “Fonte salsa”. Në italisht, përkufizimi “Fonte salsa”, ose “salsa (geologia)” shpreh një fenomen gjeologjik vullkanik me intensitet të ulët, që shfaqet në nxjerrjen dhe derdhjen jashtë mbi sipërfaqe të tokës, të baltës e ujit të kripur, të përzier shpesh me lloje të ndryshme të gazeve. Ky veprim vullkanik ndodh në temperaturë të

ulët (të afërt me temperaturën e ambientit), në ndryshim me dukurinë tjetër të llavës së nxehtë vullkanike. Mëpas nga uji i kripur mund të nxirret kripë, pasi të avullojë uji. Kripa e prodhuar shpesh është me cilësi shumë më të lartë se ajo e detit.

8 Malet e Ballkanit në lashtësi, në kohën e Ptolemeut, quheshin Haemus Mons(lat.), ose Catena Mundi Mons [Vargmalet e botës].

9 Nuk është e qartë se cilat male ka nënkuptuar relatori (V.Z.) me “monti Carpazi”, që sipas tij ndajnë kufirin mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, por në fakt nëse e ka fjalën për malet Karpatë (Carpazi), ato shtrihen më thellë në lindje; nisur nga Europa qendrore

drejt lindjes dhe juglindjes së kontinentit, nga Sllovakia nëpër Çeki, Poloni, Ukrainë, Rumani dhe Serbinë lindore.

10 Imzot Vinçenc Zmajević? (1670-1745) ishte 31 vjeç në vitin 1701 kur u emërua Kryepeshkëv i Tivarit. Në vitin 1702 u konfirmua nga Papa Klementi XI si Vizitor Apostolik në Shqipëri, dhe në këtë vizitë ai ka shkëlur vetë burimin e kripur, sipas dokumentit.

11 Këto shtigje cekën dhe në veprën “Località, chiese, fiumi, monti, e toponimi vari di un’antica carta dell’Albania Settentrionale”(Ermanno Armao, Roma, 1933) kur shqyrtohen toponimitë “Salza villa(Merturi) dhe “Agar Monti”.

Shkrimi është botuar tek revista “Hylli i Dritës” numri 2, 2016, Shkodër]

FUTBOLL PA KUFIJ ADRIATIKË

Nga Giacomo Mazzocchi

Ka vende, njerëz dhe rrethana që ndodhin në jetë sikur të ishin të paracaktuar. Mua më ndodh, për shembull, me Shqipërinë, një lloj miti.

Kam kaluar vitet e Luftës së Dytë Botërore i zhvendosur në një fshat të largët të Bazilikatës, madje Provincë e Potencës, të vendosur në krye të një mijë metrave. Prej aty ishte e mundur të shihje përreth për të parë herë pas here qendra të tjera të banuara që uleshin në majë të maleve. Vende të zgjedhura për t'ia mbathur, ose më mirë për t'u rezistuar bastisjeve të piratëve saracenë. "Mami, turqit!".

Një nga këto, më vuri në dukje gjyshi im, quhej Albano di Lucania. U tha se emri rrjedh nga fisniku Norman Filippa d'Alba. Në fakt, fshati e kishte marrë emrin nga një grup shqiptarësh që u vendosën për fat të mirë pothuajse në të gjithë Italinë jugore: nga Sicilia në Puglia. Isha kaq i magjepsur nga këto histori sa një mëngjes binda një mikun tim aventurier për të arritur në Albano duke ecur nëpër shtigje dhe këngë.

Arritëm pas 12 orësh në këmbë të shkatërruar dhe të uritur.

"Shqiptarët" u kujdesën për ne. Na ushqyen. I dërguan telegraf gjyshit tim për t'i treguar atij se ku ishim. Dhe ata na pritën deri në ditën tjetër që ai erdhi të na merrte me kamionin që përdorte për të grumbulluar ujë. Mbaj mend një fshat plot me kisha. Dhe me njerëz bujarë. Kur u rrita dhe luaja futboll, kthehesha shpesh për të vizituar këta miq në sfidat e futbollit mes dy vendeve. Kurrë nuk kam njohur njerëz më mikpritës.

Vendet mund të njihen edhe nëse nuk keni shkuar kurrë atje, nëpërmes njerëzve tipikë që jetojnë atje. Të zbulosh se si ata janë bërë nga brenda, do të thotë të marrësh një ide për vendet: më trego ku jeton dhe unë do të tregoj se kush je dhe anasjelltas! Për mua, Shqipëria është mbi të gjitha Vlora. Atje ku Adriatiku dhe Joni bashkojnë ujërat e tyre për të lagur një bregdet të bukur dhe të prerë.

Kam qenë atje vetëm një herë. Në kohën kur një avokat brez gjysëm-invalid, Paolo Pinto, përdorej për të notuar në Adriatik. Kur një agim u lye me graso kundër ngrirjes, u nis në Vlorë për të arritur në Gargano pa u ndalur asnjë herë dhe pa hipur në barkë as për të pirë, isha i pranishëm edhe unë në imbarkim dhe doja t'i tregoja rrugën e duhur dhe ta shpëtoja nga kandelët e detit.

Unë kisha ardhur natën më parë nga Vieste al Gargano në një gomone. Brigjet dhe qytetin e Vlorës i memorizova direkt. Shqipëria dhe fati. Ndoshta ato transmetohen me ADN. Vëllai i gjyshit tim nga babai, Guido Mazzocchi, për arsye të veta që unë kurrë nuk i dita, ishte aq i dashuruar me Shqipërinë sa në vitin 1911 e pa të arsyeshme të bënte një udhëtim të gjatë me kalë lart e poshtë Shqipërisë për të dokumentuar me vizatimet e tij një realitet të

bërë aktualitet për revoltën kundër sundimit otoman turk. Ditari i tij dhe i gjithë dokumentacioni është paraqitur nga Kisha e Nderuar në Dhomën e Parlamentit italian, e cila është mbështetje e lëvizjeve politike të parlamentit.

Xhaxhai Guido vdiq si një piktor mjaft i cituar 95 vjeç dhe ia doli me tregimet e tij të transmetonte atë që kishte mbledhur. Si një njeri i rritur dhe jetuar në Jug, mes Lukania-s, Kampania-s, Kalabria-s e Sicilisë, pjesëmarrja ime shqiptare në Itali nuk është e vogël, por takimi me familjen Aliaj, në Grottaferrata (Colli Albani = Kodra Shqiptare?!) ka ofruar patjetër rastin për të thelluar, edhe nga larg, një vizion të besueshëm të Vlorës, njerëzve dhe kulturës së saj. Kolegu Hasan Alijaj është vendosur për vite me radhë në Grottaferrata, ku zbarkova edhe unë pas shumë vitesh xhiro nëpër botë. Më interesonte tek ai përpjekja për të promovuar njohuritë e ndërsjella midis Shqipërisë dhe Italisë, përmes botimit të revistës në gjuhën shqipe dhe italiane "Rrënjët", në këto ditë ka marrë titullin si gazeta e vitit 2017 nga Akademia Alternative Pegazi Shqipëri.

Kështu nuk pata vështirësi ta ndihmoja të promovonte ngritjen dhe specializimin në Itali të disa prej nipërve të tij me talent të madh sportiv. Më i madhi ishte boksi i Franc Aliaj. Një peshë shumë e mirë për grushte nga Tyson. Boksi? Për gjysmë jete kam qenë i përfshirë në boksi dhe jam regjistruar për 152 tituj botërorë. Për fat të keq, boksi në Itali është pothuajse i vdekur. Mbijetojnë disa ishuj tradicionalë, sidomos në mal, pjesa tjetër ngjiten në ring për të formuar trupin dhe për të mësuar të mbrohen, por luftimi? Më mirë ta lëmë fare. Mbledhjet e boksit janë të pakta dhe mungon interesi i vërtetë konkurrues dhe publik, sepse karrierat mbrohen me kujdes nga menaxherët në bashkëpunim me arbitërat dhe gjyqtarët. Që pothuajse gjithmonë boksi i asistuar më mirë bën karrierë duke përballuar kundërshtarët aventureskë të gatshëm edhe për të marrë ndonjë grusht dhe të humbasin për një qese të mirë.

Një që godiste fort si Aliaj, do të gjente vështirësi të luftonte në Itali duke shkatërruar çdo kundërshtar, u përpoq megjithatë të organizonte personalisht në Fraskati "NATA E BOKSIT NËN YJE" duke përdorur Sheshin Kryesor nga Komuna. Por, kur gjithçka ishte organizuar dhe ishte gjetur kundërshtari për Tyson të Vlorës, shoqatën e tregtarëve tuskolanë dhe do të bënte biznes për gjatë gjithë natës, në minutën e fundit tërhoqi sponsorizimin e tij. Kapërceu kështu gjithçka. Dhe me boksin në Itali, fjalimi im përfundoi.

Megjithatë, familja Aliaj nxjerr vazhdimisht të rinj me karakteristikat e kampionit. Disa vite më parë Hasani më prezantoi një tjetër nip të tij. Shahin Aliaj, 16 vjeç, kombëtar nën çdo kategori moshash. Një fizik si i Ibrahimoviç, i gjatë 1.97 m. Përmes agentit Fifa dhe prokurorit Simone Canovi kontaktoj me miqtë e Romës, kampionin e botës Bruno Conti, dhe me Drejtorin Sportiv të Lazio-s, Iglj Tare, gjak i pastër shqiptar. Ai, i vendosur përpara bardh e blu-ve, unë oficer i shtypit kishim bashkëndarë një sezon përtacie në 2007-'08.

I kulturuar, i diplomuar, i aftë për të folur gjashtë gjuhë, ishte shumë i aftë me mediat dhe unë intervistova gjithmonë atë, me kënaqsinë më të madhe nga të gjithë.

Nuk ishte e vështirë të organizohe në një javë dy ditë "provash në Romë në qendër të Trigoria" dhe një ndeshje gjysmë zyrtare në Lazio në atë të Formellos. Shahini udhëtoi me anije deri në Brindisi dhe me autobus deri në Romë përpara stërvitjes-provë të programuar për në pasdite. Djali, natyrisht ishte i provuar, por ai nuk u anka dhe kërkoi të bënte maksimumin.

Kishte problemin gjuhësor të të kuptuarit dhe u gabua në lidhje me rolin e tij. Roma e la të majtë të jashtëm ndërkohë që pozicioni i tij i zakonshëm ishte sulmues qendror me preferencë në të majtë. Roma në atë periudhë kishte modifikuar të gjitha metodat e përgatitjes, me ardhjen e Luis Henrique, teknik spanjoll nga Barcelona, ku pastaj u rikthye. Stili i tij absolutisht i ndryshëm nga ai i stërvitjeve tradicionale si në Itali ashtu si dhe në Shqipëri... skema totalisht të panjohura për djalosin Aliaj. Po brumi ishte. Vullneti gjithashtu. Ai u përpoq të interpretonte atë që mundej në përshtjellim, duke u përpjekur të imitonte atë që bënin nxënësit e tjerë. Një gjë ishte krejtësisht e saktë, që ky djalos shqiptar, i cili ishte rreth dy metra i gjatë, kishte një trup të shkathët dhe jashtëzakonisht të koordinuar dhe teknikisht të formuar.

Dhe se në futbollin për të rritur një udhëheqje teknike e përshtatshme do ta bënte me siguri një profesionist të shkëlqyer dhe ndoshta një kampion, duke parë edhe personalitetin e tij të përshtatshëm dhe gatishmërinë. Prova ok, pavarësisht mosnjohjes së periudhës të përshtatjes të nevojshme për të asimiluar gjërat e reja. Por tani prova është në Lazio. Gjërat po shkojnë më mirë. Nuk është një stërvitje me skema të panjohura për t'i ndjekur dhe interpretuar, por për të luajtur një ndeshje të vërtetë kundër kundërshtarëve të vërtetë. Formimi titullar i Lazios që të dielën do të zbresë në fushë. Është për t'u dridhur: ai, Shahin Aliaj, si një qendror në formimin Pranvera të Lazios, përballet me mbrojtjen e një prej ekipeve më të mira të Serisë A.

Përbri tij djem dy ose tre vjet më të mëdhenj. Detyra e tyre është të bënin rolin e partnerëve mësues në Skuadrën e Parë në dukje të ndeshjes të së dielës, por kur e kanë ata topin duhet të hidhen në veprim. Shahini tregon që e njeh pjesën e tij, gjithmonë në lëvizje në mënyrë që të bëhet i pashënur për kalimin e shokut, ose mbrojtje e topit duke shfrytëzuar fizikun e tij. Arrin madje të prekë dhe rrjetën. Në fund, shumë përgëzime, por ka një por. Nuk ishte i pranishëm përgjegjësi i sektorit të të rinjve Simone Inzaghi. I angazhuar papritur diku tjetër. Do t'i referohet gjithçka. Ndoshta është momenti të bëhet një tjetër provë. Por djali duhet të rikthehet në Vlorë. Ka të gjitha gjërat në rregull. Por rrethanat nuk janë në favor. Dhe djali kapërcen Adriatikon. Pavarësisht përvojës mbetet gjithmonë një lloj mirazhi për Aliaj. Një pikë arritje historike për shumë shqiptarë. Kështu, babai Edmond Aliaj dhe xhaxhai Hasan Aliaj, kur e vënë re se vetëm 11 vjeç edhe Fiori shfaq pamje kampioni. Mes lojtarëve të së njëjtës moshë bie në sy, dhe duhet të luajë me 13 vjeçarët Under për t'u hasur me kundërshtarë të të njëjtit fizik dhe teknik. Në internet fillojnë të qarkullojnë fotot e këtij fëmije të gjatë sa një i rritur dhe me flokët e arta që mbjell rrëmujë në radhët e kundërshtarëve. Shumë klube italiane si Torino do të donin ta kishin për vete. Aliaj vendosin që Italia të jetë rruga

për t'u ndjekur. Dhe në veçanti Roma ku banonte me xhaxhain e tij Hasanin dhe familjen e tij, që përfshin edhe kushërin bashkëmoshatar, Enrin, futbollist të Grottaferrata-s. Një situatë ideale duke pasur parasysh që për të shkuar ose ardhur nga Vlora në Romë duhen 50 minuta. Kohë që në Romë duhet për t'u spostuar me makinë nga një lagje në tjetrën. E thënë, e bërë. Simone Canovi, dirigjent i ri i të rinjve të Romës, organizon një javë stërvitjeje me një Akademi futbollit të kryeqytetit të lidhur me Klubin e Futbollit Sampdoria. E para gjë që ndodh në fushën e Fiamme Oro a Tor di Quinto është që Fiori rrëmbehet në grupin e trembëdhjetë vjeçarëve kaq e madhe është diferenca fizike dhe teknike mes tij dhe bashkëmoshatarëve të tij njëmbëdhjetë vjeçarë. Problemi kryesor për Fiorin është të kuptojë atë që duhet të bëjë në ushtrimet e veçanta të stërvitjes që iu kërkohet djemve për të ndjekur. Siç i ka ndodhur vëllait me Romën, bëhet fjalë për gjëra të pa bëra më parë. Tekniku indoktrinon grupin sigurisht në italisht. Fiori duhet të ndihmohet me figurën derisa të fillojë ndonjëri. Por nuk është e thjeshtë sepse skemat duhet të ndiqen me top dhe shpesh me trekëndësha të ndërlikuar. Herë pas here kryetekniku Massimo ndërpret gjithçka. I ul fëmijët përtokë dhe shpjegon gjatë. Fiori nuk kupton dhe shpreh një fytyrë të mirë në lojë të keqe. Një ekperiencë acaruese që Fiori e përballon me kokëfortësi i gëzuar. Por, ditën e dytë, ndodh diçka shumë e dobishme. Një djalë paraqitet me një fjalor të vogël italisht-shqip. E ka bërë spontanisht duke marrë parasysh vëshirësitë e hasura nga djali i huaj. Një gjest shumë i bukur që e ngazëllen Fiorin. Gjithsesi, ai nuk dorëzohet. Dhe më në fund, për fat të mirë, pasi braktisen ushtrimet, kalohet në lojë me top në hapësira të ngushtuara. Erdhi më në fund momenti i tij: fundi i teorisë dhe i zhgënjimit, triumfi i praktikës dhe i Fiori Aliaj. Simpatik, i disponueshëm, i bukur, i pashëm me shpatulla të gjera dhe bel të ngushtë, Fiori ka bërë për vete të gjithë njerëzit e pranishëm (dhe janë shumë) në stërvitje. Pjesa më e madhe prindër, por edhe vëzhgues të thjeshtë dhe kureshtarë. Apoteoza mbërrin ditën e fundit kur ndeshen në një fushë të rregullt përfaqësuesit e Romës dhe Sampdories. Fiori hyn në fushë me skuadrën e parë: është konfuz, por krenar. Luhet me radhë: atij i takojnë kohët përmbyllëse. Fillimisht fëmijët e tjerë ndoshta e injoronin sepse ishte i ri dhe preferonin t'ia kalojnë topin shokut. Por, kur pastaj sfera përfundon te Fiori e kuptonjë që vjen nga një planet tjetër dhe se me atë fitohet. Shembullore ajo çfarë ndodh kur arbitri shënon një goditje dënimi në favor të skuadrës së Fiorit 25 metra larg nga porta. Një djalë i vogël vendos topin, por Massimo e thërret dhe komandon që të jetë Fiori ai që gjuan. Trajneri ekspert ka kuptuar gjithçka. Pa asnjë sforcim, goditja e këmbës së Fiorit është e denjë për një lojtar të rritur dhe të vërtetë. Topi prek shtyllën. Duartrokitje në skenën e hapur. Fiori u adoptua nga të gjithë, edhe nga mamatë që nuk ishin aspak xhelozë. Çdo ndërhyrje e tij - driblim, mbrojtje, sulm, gjuajtje, shoqërohej me duartrokitje dhe nxitje. Nuk më kishte ndodhur kurrë një gjë e tillë.

Përktheu, **Nikolin Sh. Lëmezhi**,
Vëllazëria **Jeruzalemi i Ri** - Shkodër

Zhdukja e dy objekteve të tjera të rralla në Shkoder

Po na humbet trashigimia e artit tonë të mrekullueshem popullor shqiptar, si dhe kryeveprat arkeologjike, të cilat janë të parekuperueshme. Në një shkrim të 2006-s, ndër të tjera autori shkruen: "...Shtëpinë e Pagetit e ruante i quejtuni Pjetri i Çisë. Në mungesë të Lordit në Shkoder, shtëpia mbikeqyrej prej xavendës konsullit ingliz Kolë Sumës....".

Per familjen shkoderane Suma kam shkruar shkurtimisht kur kam trajtuar problemin e OXHAKUT të Sumajve të zmontuem nga shtëpia e tyre dhe të montuem në shtëpinë muzë të Luigj Gurakuqit e cila po prishet.

Çeshtjet e historisë së familjeve të mdhà jo vetem në Shkoder, por kudo janë të nderthuruna ndermjet tyre....

"Historia e oxhakut të një familjeje të madhe shkoderane".

Shtëpia-muzë e Luigj Gurakuqit në Shkoder, që gjendej në rrugën me të njajtin emen, nuk ishte vetem shtëpia e një nder patriotëve ma të mdhej tonë, por ishte njikoheshisht edhe një shtëpi karakteristike e qytetit të Shkodres ku shifej edhe arti popullor, qoftë në veshtrimin e nderimit, qoftë në paisjet e orenditë shkoderane. Aty ishte tavani i druajt me ornamente të skulpturueme, ishin dyert dhe dritaret me dru të gdhenun si dhe një oxhak karakteristik, që ka një histori të veçantë.

Simbas dr. Kadri Kerçikut në librin e tij "Zhvillimi i shndetësisë në Shkoder gjatë shek. XVIII-XX" botue në Tiranë në vitin 1962, mjeku i parë i diplomuem shqiptar me sherbim në Shkoder ka qenë Kol Suma-Heqimi, që në vitin 1795 permen-det nder regjistra Nicolò Medico. Studimet ai i kishte krye në Venedik. Ky ka qenë martue në vitin 1792 me të motren e farmacistit Françesko Tedeschini e cila e la te vej. Mbas një martese të dytë ka pasë një djal Gjonin. Ne moshen 60 vjeçar ai vdiq. Kolë Heqimi-Suma ka qenë mjeku i vezirit Ibrahim Pashe Bushatliut.

Nipi i tij mjek i quejtun edhe ky Kolë Suma ka qenë nenkonsull i Anglisë në Shkoder. Shtëpia e familjes Kolë – Gjon – Kolë – Gjon – Kolë (Lec) – Gjon Suma (vdekë në vitin 1995), ka qenë një shtëpi jo vetem karakteristike shkoderane, por ka qenë edhe një shtëpi me prestigj ku priteshin patriot, intelektual dhe personalitete diplomatike. Me kujtohet salla e madhe me zbururime-gdhenje druni, me piktura e me orendi luksoze.

U zgjata pak me këtë histori anësore per të tregue se si mund të imagjinohet

të këtë qenë oxhaku i dhomes së pritjes ne familjen Suma (Shiko foton e oxhakut ketu ma siper). Mbas prishjes së kësaj shtëpie monument-kulture në vitin 1962, muzeumi i Shkodres e zmontoi këtë mrekulli dhe e montoi në shtëpinë muze të Luigj Gurakuqit pikrisht në atë shtëpi,

që kohët e fundit asht prishë "nga pakujdesia". Simbas të dhanunave të sakta që kam marrë nga profesor Willy Kamsi ky oxhak sot asht shitë në Greqi. Autoritetet rrijnë dhe shikojnë? Jo! Autoritetet rrijnë dhe nuk shikojnë!

Po TAVANI i kësaj shtëpie ku shkoi?



Në rrugën-muzë në rrugën e Gjuh-adolit dhe pikrisht ku ajo bashkohet me shetitoren kryesore të Dugajt e Reja në Shkoder, sot e gjitha zonë muzë, lagje e banueme kryesisht nga katolik, shumica nderatesa stil europian të projektueme nga piktori dhe arkitekti i njohtun Kol Hidromeno, pra pikrisht aty gjindet një shtëpi dykatëshe, ku në katin perdhë dikur ka qenë dyqani i qumshtit dhe siper banoshin familja e të nderit profesor Gasper Ugashit dhe familja e Garxholajve.

Në vitet '80 kati perdhë asht kenë per-dore nga Muzeu i Shkodres si ekspozite etnografike natyrisht tue krijue edhe një ambjent antik të dhomave. Në njenen prej dhomave ka qenë i fiksuem në tavan një TAVAN i mrekullueshem (4 x 4 meter), me dru të skulpturuem me një art të nivelit të naltë. Unë nuk kam pasë rastin të shof ndokund tjetër një tavan ma të bukur se atë. Edhe ky tavan asht kene zmontue nga shtëpia e Sumajve dhe pikrisht nga shtëpia e zevëndes konsullit te inglizit Kolë Suma, i cili mbikqyrte shtëpinë e lordit anglez në mungesë te tij.

Deri para disa vitesh kjo nderatesë ku e kishin transferue TAVANIN, ka qenë pronë e dajave te mij 80-vjeçar Anton dhe Niko Prensushi, shtetas shqiptar, lindun dhe me banim të perhershem në Trieste. Ato këtë nderatesë të tyre e paten shitë dhe tash aty me duket se po bahen disa punime ndertimi. "TAVANI" i fiksuem në tavan nuk asht pjesë perbase e shtëpisë se shitun. Pronar i fundit i ketij tavani ka qenë Muzeu i Shkodres, i cili ia ka pasë marrë familjes së trashigimtarve Kolë Sumes, një nder trashigimtart direkt e të cilit kishte me kenë grueja e ime. Por ky fakt nuk ka randesi as per shkrimin, as per pronësinë.

Randesi ka që të gjendet ky TAVAN dhe të vendoset në Muzeun e Shkodres si NJI PASUNI E RRADHË E ARTIT ARTIZANAL SHKODRANË, E ARTIT TË MREKULLUESHEM ARTIZANAL SHQIPTAR.

Paul Tedeschini, gazeta "DITA",
3 mars 2018

Shkrimi "'Suksesi" i turisit - hulumtues austriak në një fotoekspozitë të manipuluan", botuar në numrin 172, është shkruar nga z. Gjon Bruçi

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION **Kimay** Produzione Giacche

